

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5932
E shtunë, 16 nëntor 2019
çmimi 0.40 €

Që nga paslufta në
aksidente trafiku humbën
jetën 2 523 persona | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", MIMOZA KUSARI-LILA | FAQE 4-5

ZGJATJA E PROCESIT ZGJEDHOR PO SJELL SKEPTICIZËM PËR REZULTATIN



Kryetarja e Alternativës, njëherësh deputete e zgjedhur në zgjedhjet e 6 tetorit, Mimoza Kusari-Lila, ka vlerësuar se zgjatja e procesit zgjedhor është duke dëmtuar kredibilitetin e këtyre zgjedhjeve. Në këtë intervistë dhënë për

gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se rinumërimi i votave po sjell dyshime dhe skepticizëm për rezultatin që mund të pasojë nga ky proces. Megjithatë, Kusari-Lila ka deklaruar se Alternativa është që asnjë vote të mos i

humbet vlera. Ajo ka lavdëruar procesin e bisedimeve në mes të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës, duke thënë se për herë të parë po ndodh një diskutim serioz për formimin e një koalicioni qeverisës

NISMA SOCIALDEMOKRATE DHE LËVIZJA VETËVENDOSJES 'PËRPLASEN' RRETH PROCESIT TË RINUMËRIMIT TË VOTAVE

Daka, partive politike: Tregoni kujdes maksimal në procesin e rinumërimit të votave



Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, ka thënë të premten se i mirëkupton vërejtjet për kohëzgjatjen e procesit zgjedhor por, sipas saj, KQZ-ja e ka për obligim ligjor t'i zbatojë vendimet e institucioneve gjyqësore.

119 gjoba
për ndotësit e
mjedisit gjatë
muajve
shtator - tetor

FAQE 5



OPINION

GJYKATA SPECIALE PO
I FYEN DHE POSHTËRON
VIKTIMAT E LUFTËS,
DËSHMITARËT DHE
INSTITUCIONET E KOSOVËS

Nga Musa
SABEDINI

F. 11



AKTUALE

PLANIFIKIMI I DUHUR
I BUXHETEVE KOMUNALE,
PARAKUSHT PËR ZHVILLIM
EKONOMIK LOKAL F. 6

FSK-së I SHTOHEN EDHE 337
PJESËTARË TË RINJ F. 7

EKONOMI

NËNSHKRUHEN GJASHTË
UDHËZIME ADMINISTRATIVE NGA
FUSHA E KADASTRËS DHE
REGJISTRIMIT TË PRONËS F. 9

KONSUMI I ENERGJISË
ELEKTRIKE NË KOSOVË SHËNOI
RRITJE PËR 11.80 PËR QIND F. 8

KULTURË

KOMUNITETI ARTISTIK
NDERON REGJISOREN E
NDJERË ARZANA KRAJA F. 9



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Viasa, p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Stoltenberg: I takon Serbisë të vendosë për çështje të teknologjisë

BRUKSEL, 15 NËNTOR - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg tha se i takon Serbisë të vendosë se çfarë lloji të teknologjisë dëshiron të ketë.

I pyetur nga "Zëri i Amerikës" për shqetësimet në rritje në lidhje me rolin e Kinës në rajonin e Ballkanit Perëndimor, kur bëhet fjalë për teknologjinë e saj 5G, Stoltenbergu tha se ekzistojnë kushte që NATO-ja u kërkon vendeve anëtare sa i

përket teknologjisë 5G, mirëpo sipas tij, kjo nuk vlen për vendet që nuk janë anëtare të Aleancës. "Ne mund t'i këshillojmë ata, por varet nga Serbia që të vendosë se çfarë lloj telekomunikacioni dëshiron dhe si e organizon infrastrukturën e saj civile. Ne e mirëpresim faktin që Serbia është një partner i ngushtë i NATO-s. Ne po bashkëpunojmë me Serbinë", tha Stoltenbergu.

5G është gjenerata e fundit e teknologjisë së internetit që ofron për përdoruesit qasje në internet me një shpejtësi shumë më të madhe sesa ofrohet aktualisht. Mirëpo, ekzistojnë shqetësime në shumë vende, që Kina po e përdor këtë teknologji për qëllime qeveritare dhe për t'i spiunuar përdoruesit. Kompania kineze e teknologjisë Huawei po synon të investojë më shumë në tregun serb.



MPJ-ja kërkon nga Brukseli mos ta ndërlihdë dialogun me heqjen e vizave

Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës thotë se ideja që liberalizimi i vizave për qytetarët e vendit tonë të ndërlihdet me përfundimin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë është shkelje eklatante e së drejtës për lëvizje të lirë dhe është edhe ngatërrim i dy proceseve që nuk mundet dhe nuk duhet të ndërlihdhen



PRISHTINË, 15 NËNTOR - Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës e ka cilësuar si të gabuar përpjekjen e disa zyrtarëve të rinj në Bruksel për të lansuar idenë që liberalizimi i vizave për qytetarët e vendit tonë të ndërlihdet me përfundimin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Kjo ide jo vetëm që është shkelje eklatante e së drejtës për

lëvizje të lirë, por po ashtu është edhe ngatërrim i dy çështjeve, pra dy proceseve që nuk mundet dhe nuk duhet të ndërlihdhen". "Dialogu si mjet i vetëm për ruajtjen e paqes dhe sigurisë së qëndrueshme në rajon në mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë ka për qëllim të ndërtojë bazamentin për vendosjen e

marrëdhënieve të mira ndërfaqinësore", është thënë në reagimin e MPJ-së. Sipas MPJ-së, dialogu në mes Kosovës dhe Serbisë dhe proceset në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian duhet të ecin ndaras

dhe pa kushtëzime.

"Qytetarët e Republikës së Kosovës nuk duhet të mbahen peng të ideve 'interesante', tekeve dhe vullneteve të pamatura dhe imponuese, pavarësisht se nga kush vijnë si

ide". "Dialogu duhet të ketë rrjedhën e vet dhe nuk duhet të hasë në obstrukcion nga ide që kanë për qëllim ta ndryshojnë kontekstin e zgjidhjes së problemeve të grumbulluara nga konflikti Republikë e Kosovës - Republikë e Serbisë, në një kontekst rajonal, apo në procese që Kosova ka karshi Brukselit zyrtar", është thënë në këtë reagim.

Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës ka theksuar se jokonstruktiviteti i imponuar dhe superior do t'i mbingarkojë agjendat, sepse imponimet dhe devijimet kanë premisa të keqkuptimit dhe keqinterpretimit, dhe për më tepër vështirë se do të hasin në mirëkuptim për të ofruar zgjidhje të pranueshme.

Pendarovski kundër anëtarësimit në Unionin Ekonomik Euroaziatik



SHKUP, 15 NËNTOR - Presidenti Stevo Pendarovski beson se Maqedonia e Veriut nuk duhet të bëhet anëtare e Unionit Ekonomik Euroaziatik, sepse është në kundërshtim me aspiratat e vendit për anëtarësim në BE. Ai e justifikoi thirrjen e kryeministrit Zaev, që kompanitë ruse duhet të hyjnë në tregun e Maqedonisë më

intensivisht. "Bashkimi Ekonomik Euroaziatik është çështje krejt tjetër. Serbia ka nënshkruar kohët e fundit dhe tashmë ka sinjale nga Brukseli se ato dy gjëra, Bashkimi Evropian, negociatat dhe anëtarësimi dhe Unioni Ekonomik Euroaziatik nuk janë kompatible", tha Pendarovski. Ai, gjithashtu, justifikoi

vendimin e vendit për të mos vendosur sanksione ekonomike ndaj Rusisë, pas një thirrje nga Shtetet e Bashkuara disa vjet më parë. Ai thotë se derisa të mos bëhemi anëtar i plotë i NATO-s, ne mund të lejojmë të ruajmë nivelin shkëmbimit tregtar me Rusinë. Vendi nuk do të kishte zgjidhje pas anëtarësimit në organizatat

euro-atlantike. "Ne jemi ekonomi në zhvillim, kemi vështirësi të mëdha ekonomike, vuajmë të arrijmë shkallë më të larta të rritjes ekonomike, ende nuk e kemi konsoliduar atë pjesë të shoqërisë sonë dhe mendoj se sanksionet drejt Federatës Ruse mund të ndikojnë negativisht ndaj ekonomisë maqedonase", tha Pendarovski.

Studentët nisin protestat masive më 4 dhjetor

TIANË, 15 NËNTOR - Më 4 dhjetor studentët në gjithë Shqipërinë pritet të nisin protestat masive kundër qeverisë "Rama", për ligjin e Arsimit të Lartë. Lëvizja për Universitetin, organizata rinore që zhvilloi fiks një vit më parë protestat më masive rinore, ka njoftuar tw premtën nisjen e tubimeve në gjithë vendin. Të rinjtë që drejtojnë këtë organizatë thonë se studentët kanë kërkesa të qarta kundër qeverisë "Rama" dhe kërkojnë

plotësimin e tyre të menjëhershëm. "Me mijëra në protestë! Më 4 dhjetor, në njëvjetorin e nisjes së protestave madhështore të studentëve, mblihdemi sërish me mijëra në protestë: Kundër Ligjit të Arsimit të Lartë, financimit të universiteteve private me paratë tona, abuzimit me të drejtat e studentëve", thuhet në njoftimin e shpërndarë për gjithë rrjetet studentore në vend. Studentët kanë renditur një listë me kushte ndaj qeverisë që nisin

me arsim cilësor, dyfishimin e buxhetit të arsimit të lartë, përgjysmimin e të gjitha tarifave, votë të barabartë studentë-pedagogë, kushte dinjitoze studimi dhe jetese, perspektivë punësimi profesional. Lëvizja për Universitetin në këtë protestë fton gjithë qytetarët që t'u bashkohen kërkesat të të rinjve. "Ne do të fitojmë! Bashkë me studentët, e gjithë shoqëria!", njofton Lëvizja për Universitetin. Një vit më parë, në muajin



dhjetor, protestat e studentëve tronditën qeverinë nga masiviteti i tyre dhe për mesazhe e forta që ata dhanë. Gjatë gati

një muaji protesta, Edi Rama u detyrua të ndërrojë gjysmën e kabinetit qeveritar nga presioni i të rinjve.

Nisma Socialdemokrate dhe Lëvizja Vetëvendosje 'përplasen' rreth procesit të rinumërimit të votave

Daka, partive politike: Tregoni kujdes maksimal për procesin e rinumërimit të votave

Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, ka thënë të premten se i mirëkupton vërejtjet për kohëzgjatjen e procesit zgjedhor por, sipas saj, KQZ-ja e ka për obligim ligjor t'i zbatojë vendimet e institucioneve gjyqësore. Daka ka theksuar se aktualisht janë duke zbatuar vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia për rinumërimin e më shumë se 1 400 vendvotimeve. Ajo ka kërkuar kujdes maksimal nga përfaqësuesit e subjekteve politike dhe vëzhguesit në procesin e rinumërimit në QNR



EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, ka thënë se procesi zgjedhor është në fazë të rëndësishme të tij dhe se aktualisht si institucion janë duke zbatuar vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) për rinumërimin e më shumë se 1 400 vendvotimeve. Ajo u ka bërë thirrje përfaqësuesve të subjekteve politike dhe vëzhguesve të tyre të tregojnë kujdesin maksimal për integritetin e procesit që po zhvillohet në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR). "Në këtë fazë e shoh të nevojshme që ta jap këtë mesazh për të gjitha palët që janë pjesë e procesit si dhe duke ftuar përfaqësuesit e subjekteve politike dhe vëzhguesit e tyre ta tregojnë kujdesin maksimal për integritetin e procesit që po zhvillohet në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, t'u përmbahen rregullave dhe procedurave të Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve dhe ta ruajnë qetësinë e t'i shërbejnë procesit demokratik. Gjithashtu, u bëj me dije se çdo cenim i procedurave dhe rregullave të Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve është në kundërshtim me deklaratën e vëzhguesit të nënshkruar prej tyre si dhe në kundërshtim me ligjin", ka thënë Daka të premten.

Ajo ka shtuar se zyrtarët e numërimit duhet të lejohen ta kryejnë punën e tyre në mënyrë të lirë, të papenguar dhe profesionale. "Çdo ndërhyrje në punën e zyrtarëve të numërimit vështirëson dhe ngadalëson procesin për certifikimin e rezultateve përfundimtare si dhe detyron KQZ-në të marrë masa ndaj personave që nuk respektojnë rregullat për vëzhgim. Çdo palë e cila ka vërejtje për administrimin e numërimit në QNR mund të

bëjë ankesë në PZAP, pasi Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme është i qartë në këtë drejtim: 'Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QNR dorëzohen me shkrim pranë PZAP-it brenda 24 orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar', është shprehur Daka, duke theksuar se mirëkupton vërejtjet për kohëzgjatjen e procesit zgjedhor, por Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e ka për obligim ligjor që t'i zbatojë vendimet e institucioneve gjyqësore dhe të gjithëve na takon të kujdesemi për këtë proces zgjedhor që të gjithë e vlerësojnë si një nga proceset më të mira në historinë e zgjedhjeve të vendit tonë", ka thënë kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka.

Nisma: Vëzhguesit tanë po ballafaqohen me presione të ndryshme nga anëtarët e LV-së

Nisma Socialdemokrate përmes një komunikate për media të premten ka bërë me dije se gjatë këtyre ditëve të rinumërimit vëzhguesit e tyre kanë vërejtur shumë parregullsi dhe janë ballafaquar me presione të ndryshme nga anëtarët e LV-së në KQZ, Nazlie Balaj dhe Adnan Rustemi. "Mbarëvajtja dhe administrimi i këtij procesi është obligim dhe detyrë e administratës së KQZ-së. Ne si parti politike vazhdimisht jemi duke përcjellë këtë zhvillim dhe gjatë gjithë këtyre ditëve të rinumërimit vëzhguesit kanë vërejtur shumë parregullsi dhe janë ballafaquar me presione të ndryshme nga anëtarët e LV-së në KQZ. Ata kanë ndërhyrë edhe duke kapur fletëvotimet, për më tepër edhe duke vendosur se cilat nga ato fletëvotime janë të vlefshme apo të pavlefshme. Prandaj, në bazë të raporteve ditore të vëzhguesve tanë në QNR, përfaqësuesit e LV-së në

KQZ, përkatësisht znj. Nazlie Balaj dhe z. Adnan Rustemi, vazhdimisht kanë ndërhyrë në tavolinat ku po bëhet rinumërimi i votave, duke kërcënuar dhe shantazhuar stafin dhe vëzhguesit e angazhuar në QNR. Të apastrofuarve më lart nuk u mjafton presioni mbi punëtorët e QNR-së dhe vëzhguesit e partive të tjera. Ata ndërhyjnë edhe fizikisht në fletëvotime", është thënë në komunikatën e Nismës.

Ky subjekt ka vlerësuar se ndërhyrjet e vazhdueshme të Nazlie Balaj dhe Adnan Rustemit në tavolinat e rinumërimit për të dirigjuar se cila votë është e vlefshme apo e pavlefshme dhe presioni që po u bëhet vëzhguesve dhe stafit të QNR-së është skandaloz dhe në kundërshtim me ligjin. "Asnjë anëtar i KQZ-së nuk ka të drejtë të ndërhyjë në tavolinat e numërimit dhe aktivisht të angazhohet në rinumërim, e aq më tepër ta marrin rolin aktiv të vlerësuesit të vlefshmërisë së votave. Gjatë këtij procesi, tash e disa herë ka ndodhur ky veprim nga këta anëtarë të KQZ-së. Sipas raporteve të vëzhguesve tanë, dje gjatë ditës znj. Nazlie Balaj dhe z. Adnan Rustemi kanë ndërhyrë në mënyrë aktive duke kërcënuar, duke rinumëruar e duke vlerësuar vota", është thënë në këtë komunikatë. Sipas Nismës, prania gjithëditore apo e shpeshtë brenda ditës e anëtarëve të KQZ-së është e pazakontë dhe sjellja e tyre e përshkruar më lart në QNR është e paligjshme. "Për më tepër, shqetësues është fakti se tanimë këta dy anëtarë të KQZ-së kanë qëndrime publike antiligjore dhe kanë qenë aktivë në deformimin dhe falsifikimin e rezultatit zgjedhor. Prandaj, i bëjmë thirrje kryetares së KQZ-së që ta ndalojë urgjentisht ndërhyrjen e këtyre anëtarëve të

KQZ-së në procesin e rinumërimit të votave. Duke ditur përgjegjësitë e qarta ligjore të anëtarëve të KQZ-së që janë të parapara me ligj, ndërhyrja e çdo anëtar i KQZ-së në tavolinat e rinumërimit është presion, është intimidim, duke shfrytëzuar pozitën e tyre për të ndikuar ndaj punëtorëve të administratës, që janë përgjegjës për rinumërimin e votave, po ashtu është qëllim për t'i penguar vëzhguesit e partive politike për ta kryer detyrën e tyre të parapara me ligj", është thënë në komunikatën e Nismës Socialdemokrate.

Vetëvendosje: KQZ-ja të garantojë numërim të saktë të secilës votë

Pas reagimit të Nismës Socialdemokrate, Lëvizja Vetëvendosje përmes një komunikate për media ka theksuar se rinumërimi duhet të bëhet në mënyrë profesionale, të paanshme dhe në përputhje me ligjin dhe procedurat. "Votuesit kanë shprehur vullnetin e tyre dhe se derisa nuk përfundon rinumërimi i të gjitha kutive deri në votën e fundit, rezultati mbetet ai që është shpallur nga KQZ-ja. Lëvizja Vetëvendosje po e përcjell me vëmendje këtë proces si dhe përmes vëzhguesve dhe përfaqësuesve tanë do të ndjekë nga afër çdo fazë të rinumërimit deri në përmbyllje të procesit. Ashtu siç kemi qëndruar në mbrojtje të votës e vullnetit të qytetarëve në ditën e zgjedhjeve e në fazat e mëvonshme, nuk do të lejojmë që ky vullnet të dëmtohet as në rinumërim", thuhet në këtë komunikatë. LV-ja ka vlerësuar se është evidente që zyrtarë dhe gjyqtarë të institucioneve janë ndikuar politikisht në marrjen e vendimeve të fundit, me synim ndryshimin

në rezultatin e zgjedhjeve të 6 tetorit. "Lëvizja Vetëvendosje është duke mbledhur fakte dhe prova të ndërhyrjes politike në marrjen e këtyre vendimeve dhe ne do të sigurohemi që të gjithë këta zyrtarë të përfshirë në këto ndërhyrje për vendime që do të duhej të ishin të bazuara në ligj e Kushtetutë, të përgjigjen para drejtësisë. Po ashtu, insinuatat dhe presionet nga subjekte partiake që qytetarët i kanë lënë jashtë përfaqësimit në Kuvend, në një kohë kur po rinumërohen mbi gjysma e votave të përgjithshme, kanë për synim ndikimin në rinumërim dhe krijimin e faktit të kryer të përfaqësimit në Kuvend. Ftojme KQZ-në që në përputhje me përgjegjësitë që ka, të garantojë numërim të saktë të secilës votë si dhe mos të bie pre e presioneve të tilla mbi numëruesit dhe stafin përgjegjës. Rezultati zgjedhor dhe vullneti i votuesve nuk mund të ndryshohet as me vendime administrative, as me presion në opinionin publik nga subjekte të caktuara", është thënë në komunikatën e LV-së. Në bazë të rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Lëvizja Vetëvendosje ka fituar më së shumti vota, pasuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës, koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Partia Socialdemokrate dhe koalicioni Nisma-AKR-PD, që tash së fundi, me vendimin e Supremes dhe PZAP-it që votat e ardhura nga Serbia të largohen nga rezultati zgjedhor, ka kaluar pragun zgjedhor dhe do të jetë pjesë e Kuvendit të Kosovës. Nga komunitetet pakicë, Lista Serbe ka fituar 10 ulëset e garantuara për komunitetin serb, kurse 10 ulëse të tjera të garantuara u janë ndarë komuniteteve joserbe.

Flet për "Epokën e re", Mimoza Kusari-Lila

Zgjatja e procesit zgjedhor po



Kryetarja e Alternativës, njëherësh deputete e zgjedhur në zgjedhjet e 6 tetorit, Mimoza Kusari-Lila, ka vlerësuar se zgjatja e procesit zgjedhor është duke dëmtuar kredibilitetin e këtyre zgjedhjeve. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se rinumërimi i votave po sjell dyshime dhe skepticizëm për rezultatin që mund të pasojë nga ky proces. Megjithatë, Kusari-Lila ka deklaruar se Alternativa është që asnjë vote të mos i humbet vlëra. Ajo ka lavdëruar procesin e bisedimeve në mes të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës, duke thënë se për herë të parë po ndodh një diskutim serioz për formimin e një koalicioni qeverisës

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Kryetarja e Alternativës, Mimoza Kusari-Lila, ka bërë me dije se zvarritja e procesit të rinumërimit të votave po sjell dyshime dhe skepticizëm për rezultatin e zgjedhjeve. Ajo ka thënë se stërzgjatja e procesit zgjedhor po dëmton kredibilitetin e zgjedhjeve të 6 tetorit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Kusari-

Lila ka vlerësuar se në këtë mënyrë po krijohet bindja për mundësinë e devijimit të vullnetit të qytetarëve. "Absolutisht po. Zgjatja e këtij procesi nuk sjell kredibilitet, por dyshime dhe skepticizëm për rezultatin që mund të pasojë nga ky proces", ka thënë Kusari-Lila. Megjithatë, ajo ka treguar se Alternativa është që asnjë vote të mos i humbet vlëra. "Si Alternativë jemi për atë që asnjë qytetari të Kosovës të mos i humbet vota dhe secila

votë të numërohet dhe të vihet në konsideratë. Gjithashtu, besojmë dhe shpresojmë se vullneti i qytetarëve të Kosovës, i shprehur më 6 tetor, nuk do të devijohet nga pazaret e mundshme politike", është shprehur ajo. Kusari-Lila ka folur edhe për bisedimet e Lëvizjes Vetëvendosje me Lidhjen Demokratike të Kosovës për arritjen e koalicionit qeverisës. Ajo ka lavdëruar bisedimet e deritashme në mes të këtyre dy partive politike, duke

thënë se për herë të parë po diskutohet në hollësi për një program qeverisës. "Është hera e parë në Kosovë që kemi parë parti të cilat me kaq seriozitet kanë punuar për sinkronizim të programeve të veta politike. Deri më tani kryesisht marrëveshjet për qeverisje në vend janë bërë në bazë të pazarit të ndarjes së posteve, ndërsa shumë pak ka pasur diskutim për përmbajtje të programeve apo për qëndrime në objektivat zhvillimore të subjekteve", ka deklaruar Kusari-Lila, e cila në zgjedhjet e 6 tetorit ka fituar votat për të qenë pjesë e Kuvendit të Kosovës. Ajo nuk pret që në këto bisedime të paraqitet ndonjë pengesë e cila do të mund ta pamundësonte arritjen e një koalicioni qeverisës në mes të LV-së dhe LDK-së. "Mendoj se ky proces ka shtuar kredibilitetin dhe besimin te qytetarët për qeverinë e re. Besoj dhe shpresoj që të vazhdohet të diskutohet për pjesën e mbetur me të njëjtën frymë, në mënyrë që të mbahet

gjithë shpresa e njerëzve për programin e Qeverisës së ardhshme të Kosovës", ka thënë Kusari-Lila.

"Epoka e re": Znj. Kusari-Lila, së fundi Gjykata Supreme ka vendosur të largohen votat e ardhura nga Serbia prej rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të 6 tetorit, kurse më herët kemi pasur vendimin e PZAP-it për rinumërim të mbi 1 400 kutive të votimit. Cili është qëndrimi juaj për këto vendime të institucioneve gjyqësore?

Kusari-Lila: Mendoj se stërzgjatja e procesit zgjedhor ka rrezik të ndikojë në humbjen e kredibilitetit. Pra, fakti se rinumërimi i votave po merr kohë shumë më tepër se gjithë procesi i fushatës zgjedhore, votimi dhe dalja e rezultateve preliminare ka shtuar nervozë dhe stres te qytetarët e Republikës sepse po krijohet bindja se mos në prapaskenë ka mundësi të devijimit të vullnetit të qytetarëve. Megjithatë, si Alternativë jemi për atë që asnjë

sjell skepticizëm për rezultatin

tyre politike. Deri më tani marrëveshjet për qeverisje në vend janë bërë në bazë të pazarit të ndarjes së posteve, ndërsa shumë pak ka pasur diskutim për përmbajtje të programeve apo për qëndrime në objektivat zhvillimore të subjekteve. Besoj se kjo është hera e parë në historinë e pasluftës në Kosovë që kemi parti të cilat kanë marrë kaq shumë kohë për diskutimin e programeve të tyre në hollësi nga ekspertët dhe nënkryetarët e partive për ta bërë një program të përbashkët qeverisës. Ka mbetur pa u diskutuar pjesa finale në mes të dy liderëve të partive politike.

"Epoka e re": Është thënë se deri më tani rreth 80 për qind i kanë harmonizuar programet e tyre. Në pjesën që kanë mbetur pa u harmonizuar qëndrimet, mund ta presim paraqitjen e ndonjë pengese për arritjen e koalicionit qeverisës?

Kusari-Lila: Mendoj se ky proces ka shtuar kredibilitetin dhe besimin te qytetarët për qeverinë e re. Besoj dhe shpresoj që të vazhdohet të diskutohet për pjesën e mbetur me të njëjtën frymë, në mënyrë që të mbahet gjithë shpresa e njerëzve për programin e qeverisë së ardhshme të Kosovës. Besoj se 80 për qindëshi është substancë e mjaftueshme duke marrë parasysh se po flasim për dy parti që asnjëherë nuk kanë qeverisur bashkë. Mendoj se është një fillim i mbarë dhe nuk do të thotë se çdo gjë të jetë 100 për qind e unifikuar, sepse pastaj edhe gjatë procesit të qeverisjes mund të ndodhin rishikime të programit qeverisës. Në praktikë ndodh që të bëhen rishikime të programit qeverisës, pas një apo dy vjetëve, edhe nëse qeveria bëhet vetëm nga një parti.

"Epoka e re": Në bazë të dinamikës së rinumërimit të votave dhe diskutimit të këtyre dy subjekteve për programin qeverisës, kur mund ta presim formimin e qeverisë së re?

Kusari-Lila: Mendoj se kjo do të ndodhë menjëherë pas certifikimit të rezultateve zgjedhore nga KQZ-ja. Se sa do të zgjasë procesi deri te certifikimi nuk e di. Duhet ta presim rinumërimin e votave dhe ta dimë rezultatin e saktë të zgjedhjeve që të shohim nëse ka pasur ndonjë lëshim në proces. Vetëm pas certifikimit të rezultateve hapet rruga ligjore për formimin e institucioneve.

"Epoka e re": Cilat, sipas jush, duhet të jenë prioritetet kryesore të qeverisë së re?

Kusari-Lila: Prioritetet kryesore të kësaj qeverie duhet të jenë një mori problemesh të grumbulluar

të shoqërisë kosovare. Së pari prioritet duhet të jetë zvogëlimi i dikastereve qeveritare, që rrjedhimisht sjell zvogëlimin e shpenzimeve dhe stabilizimin e buxhetit. Po ashtu, prioritet duhet të jetë përgatitja e buxhetit për vitin 2020. Kjo është prej punëve të para për të cilën duhet të angazhohet qeveria për shkak të afateve ligjore. Pastaj, prioritet duhet të jetë zbatimi i programit qeverisës, duke përfshirë forcimin e rendit dhe të ligjit, zhvillimin ekonomik, reformimin e administratës

publike dhe procesin e integrimi evropiane. Natyrisht, edhe dialogu me Serbinë është pjesë e punëve që e presin qeverinë e re, duke marrë parasysh këtu mesazhet e partnerëve ndërkombëtarë për këtë proces, i cili ka mbetur në gjysmë dhe nuk dihet ende se kur mund të vazhdojë. Besoj se për këtë proces duhet të kemi një vlerësim për atë se çfarë ka ndodhur deri më tash dhe një përgatitje paraprake para fillimit zyrtar të dialogut.

"Epoka e re": A mund t'ju shohim në ndonjë post ekzekutiv në qeverinë e re?

Kusari-Lila: Nuk e di, sepse postet nuk janë ndarë ende. Ajo që është e sigurt, do të jem deputete në Kuvendin e Kosovës, për çka ndihem shumë e nderuar dhe falënderoj qytetarët e Republikës së Kosovës të cilët më kanë besuar më 6 tetor. Dihet se do të na presim punë të mëdha në Qeveri dhe Kuvend. Në cilëndo sferë jam e gatshme ta jap maksimumin për ndryshime pozitive në Kosovë.

119 gjoba për ndotësit e mjedisit gjatë muajve shtator - tetor

PRISHTINË, 15 NËNTOR (ER) - "Let's Do It" ka vazhduar monitorimin e zbatimit të Udhëzimit Administrativ për Gjoba Mandatore nga inspektorët komunalë mjedisorë dhe qendrorë dhe shqiptimin e gjobave për ndotësit. Bazuar në të dhënat e monitorimit, rezultojnë se gjatë muajit shtator dhe tetor janë shqiptuar gjithsej 119 gjoba mandatore sipas këtij udhëzimi. Sipas monitorimit të bërë nga "Let's Do It" për muajt shtator dhe tetor, rezultojnë se Mitrovica i prin listës së komunave me më së shumti gjoba të shqiptuara, gjithsej 23, pasuar nga Ferizaj me 21 gjoba të shqiptuara, Peja 16 dhe Deçani ku janë shqiptuar 12 gjoba.

Me nga 7 gjoba të shqiptuara lista vazhdon me Komunën e

Gjilanit dhe Shtimes, pasuar nga Komuna e Prishtinës, Vushtrrisë, Kamenicës, Istogut dhe Klinës me nga katër gjoba të shqiptuara për ndotësit. Ndërsa gjatë muajve shtator dhe tetor, në Komunën e Rahovecit, Obiliqit dhe Drenasit janë shqiptuar nga tri gjoba, në Komunën e Suharekës dy gjoba, derisa nga një gjobë kanë shqiptuar inspektorët e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Komuna e Malishevës dhe Komuna e Vitisë.

Në muajt shtator dhe tetor asnjë gjobë mandatore nuk është shqiptuar në komunat Fushë-Kosovë, Skenderaj, Podujevë, Kaçanik, Han i Elezit, Gjakovë dhe Lipjani.

Nga të dhënat e monitorimit

rezultojnë se lloji më i shpeshtë i gjobave të shqiptuara gjatë muajit shtator dhe tetor ishte ai i hedhjeve të mbeturinave jashtë kontejnerëve, parkimi në zonat e gjelbëruara dhe ndotja e rrugës. Udhëzimi Administrativ për Gjoba Mandatore është nënshkruar gjatë fushatës "Ta pastrojmë Kosovën" dhe ka synim reduktimin dhe eliminimin e ndotjes së mjedisit dhe shëndetin e njeriut, mbrojtjen e sipërfaqeve publike dhe private përmes menaxhimit të mbeturinave.

"Let's Do It" ju njofton se monitorimi i zbatimit të Udhëzimit Administrativ për Gjoba Mandatore do të vazhdojë edhe në muajt në vijim, kur edhe do të bëhen publike të gjitha të dhënat.



qytetari të Kosovës të mos i humbet vota dhe secila votë të numërohet dhe të vihet në konsideratë. Gjithashtu, besojmë dhe shpresojmë se vullneti i qytetarëve të Kosovës, i shprehur më 6 tetor, nuk do të devijohet nga pazaret e mundshme politike.

"Epoka e re": Mendoni se rinumërimi po e lëndon procesin zgjedhor të 6 tetorit?

Kusari-Lila: Absolutisht po. Zgjatja e këtij procesi nuk sjell kredibilitet, por dyshime dhe skepticizëm për rezultatin që mund të pasojë nga ky proces.

"Epoka e re": Gjatë kohës së numrimit dhe rinumërimit të votave kemi pasur përpjekjen e LV-së dhe të LDK-së për t'i harmonizuar programet për koalicionin e ardhshëm qeverisës. Si i keni parë këto bisedime?

Kusari-Lila: Është hera e parë në Kosovë që kemi parë parti të cilat me kaq seriozitet kanë punuar për sinkronizim të programeve të

Komuniteti artistik nderon regjisoren e ndjerë Arzana Kraja

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Komuniteti artistik ka organizuar të premten takim përkujtimor për regjisoren Arzana Kraja, e cila ka ndërruar jetë ditë më parë në banesën e vet në Lagjen Kalabria në Prishtinë. Miq, kolegë dhe profesorë thanë fjalët më të mira për regjisoren Kraja.

Mikja e studimeve, Zana Radogoshi, rrëfeu para të pranishmëve çaste me të ndjerën, duke thënë se Arzana kishte pasur rol të rëndësishëm në jetën e saj profesionale dhe personale.

Një ndër bashkëpunëtorët e saj më të ngushtë, profesori dhe aktori Shkumbin Istrefi, me të

cilin kishin qenë pjesë e serialit vendor "Kafeneja jonë" për më shumë se dhjetë vjet e, së fundmi, edhe në filmin "Fusha e mëllenjave", vlerësoi lart regjisoren e ndjerë. Ai tha se Arzana ishte e përkushtuar shumë në punë dhe kërkonte përkushtim dhe sukses në çdo projekt. Istrefi tha se regjisorja nuk bënte asnjëherë kompromis me vlerat dhe se e ka të vështirë të pranojë që ajo nuk është më.

Arzana Kraja ishte në përfundim të studimeve master për skenar filmi pasi kishte mbaruar studimet për regji dhe nuk ishte e largët dita kur ajo do ta mbronte diplomën me një tjetër shfaqje si

skenariste.

Profesori Zymber Kelmendi, i cili ishte mentor i Arzanës, tha se kishte pasur fatin të punonte me një njeri jo vetëm të talentuar, por edhe me bagazh të madh profesional. Kelmendi tha se Kraja nuk ishte vetëm regjisore e fotografive të bukura, por edhe skenariste e ideve të thella, e se ajo ishte vetëm në fillimin e një karriere të shkëlqyeshme. Ai foli edhe për veprën që ka lënë mbrapa Arzana Kraja, duke shtuar se do të kujdeset që ta realizojë. "Kisha fatin që gjatë këtij viti të fundit të jem afër Arzanës në procesin e punës së saj kreative jo si udhëheqës, por si një

bashkërrugëtues, pasi Arzana Kraja nuk ishte vetëm regjisore e fotografive të bukura, por edhe skenariste e ideve të thella", ka thënë ai.

Në sirtarin e Arzana Krajës tashmë kanë mbetur shumë skenarë e vepra të shkruara që, ndoshta, nuk do ta shohin dritën, por kujtimi për të nuk do të shuhet asnjëherë.

Në këtë takim përkujtimor të komunitetit artistik për kolegen e tyre të ndjerë u tha se puna e Arzanës do të shërbejë si mësim dhe si përkujtim se pse njerëzit duhet të respektohen dhe ta vlerësojnë njëri-tjetrin edhe për së gjalli.

Në emër të familjes Kraja foli motra e vogël e të ndjerës, Gresa, e cila tha se Arzana do të duhet të kujtohet vetëm e buzëqeshur, duke kënduar e vallëzuar dhe në asnjë mënyrë tjetër. "Arzana ka qenë shpirt i bardhë e cila na la fizikisht, por nuk do të na lë kurrë shpirti i saj. Do të jetë gjithmonë me ne, e buzëqeshur, duke kënduar e duke vallëzuar, e vetëm ashtu duhet ta kujtojmë. Në asnjë rrethanë tjetër. Në emër të familjes Kraja ju falënderoj", u shpreh ajo.

Në fund të këtij takimi që u mbajt në Teatrin Kombëtar u shfaqën edhe veprat filmike të Arzana Krajës. (KP)



Planifikimi i duhur i buxheteve komunale, parakusht për zhvillim ekonomik lokal

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ) ka mbajtur sesionin trajnues me temën "Korniza e financave lokale dhe planifikimi financiar", e cila kishte për qëllim analizën e situatës aktuale të kornizës së financave lokale dhe, po ashtu, planifikimin, menaxhimin dhe kontrollin financiar.

Pjesëmarrës në këtë sesion trajnues ishin zyrtarë nga drejtoritë për buxhet dhe financa nga komunat që janë nën 22 mijë banorë. Për më tepër, sesioni trajnues kishte për synim që përmes shpalosjes së problemeve nga komunat të dalin rekomandime

/propozime konkrete për ta lehtësuar dhe përmirësuar procesin e planifikimit dhe ekzekutimit të buxheteve.

Përgjatë sesionit u prezantuan planifikimi, menaxhimi dhe ekzekutimi i buxhetit me ipmakt në zhvillimin ekonomik lokal. Megjithatë, u theksua se agjenda e zhvillimit ekonomik lokal përfshinë strategjinë e përbashkët në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm. Njëkohësisht, komunat me përkushtimin e tyre gjatë procesit buxhetor duhet të bashkëpunojnë ngushtë me ministrinë e linjës për adresimin e sfidave të identifikuara.

Është tejet e rëndësishme që këto komuna t'i shikojnë mundësitë për financim në mënyrë që të arrijnë planifikim

të qëndrueshëm dhe ta ruajnë stabilitetin financiar. Për ta vënë buxhetin në funksion të zhvillimit duhet avancuar ndërlidhjen e planifikimit të politikave me planifikimin buxhetor. Andaj, gjatë procesit buxhetor të përkufizohet ndërlidhja në mes të prioriteteve strategjike zhvillimore të komunave dhe planifikimit fiskal afatmesëm, sidomos duke përfshirë këtu informata për performancën sipas programeve buxhetore dhe klasifikimit funksional.

Në prioritetet afatmesme duhet të përfshihen objektivat kryesore të një qeverisjeje efektive drejt një rritje ekonomike të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, mirëqenie më të fuqishme sociale dhe zhvillim sektorial.



Instituti KLGJ nëpërmes programeve edukative mbetet i përkushtuar të punojë ngushtë me institucionet qendrore dhe lokale për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve dhe për përmirësimin e politikave në funksion të

zhvillimit të qëndrueshëm. Ky aktivitet u realizua në kuadër të projektit 'Mbështetje për Komuna më të Forta dhe më të Qëndrueshme (SSSM)' i financuar nga Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë në Kosovë.

Që nga paslufta në aksidente trafiku humbën jetën 2 523 persona

Që nga paslufta kanë humbur jetën 2 523 persona nga aksidentet në trafik dhe ky numër konsiderohet i madh, ndërsa mesatarisht në vit numri i aksidenteve me fatalitet është 122. Këto të dhëna u publikuan nga Policia e Kosovës në kuadër të shënimit të Ditës Botërore të Përkujtimit të Viktimave në Trafikun Rrugor, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit, gjegjësisht Këshillin e Sigurisë në Trafikun Rrugor dhe me Shoqatën e Sigurimeve të Kosovës



numrit të viktimave në trafik në Republikën e Kosovës, si dhe theksuan hapat e ndërmarrë deri më tani nga MIT-ja, përkitazi me këtë temë.

Ndërkaq, drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Sigurimeve, Sami Mazreku, ka thënë se kompanitë e sigurimeve kanë paguar 400 milionë euro dëmshpërblim që nga pas lufta. Ndërsa vetëm më 2019, sipas tij, janë paguar më shumë se 22 milionë euro. Ndërkaq, rreth 40 milionë euro janë dëmet e këtyre kompanive nga veturat e paregjistruara të cilat qarkullojnë në trafik.

Në Ditën Botërore të Përkujtimit të Viktimave në Trafikun Rrugor autoritetet përgjegjëse thanë se do të ndërmerren edhe nisma dhe aksione vetëdijesuese për qytetarët rreth trafikut dhe rëndësisë që ka respektimi i rregullave të përcaktuara me ligj.

denteve, viktimave në Trafikun Rrugor. Bazuar në numrin e viktimave u tha se mesatarisht 122 persona llogaritet se vdesin në vit si pasojë e aksidenteve në trafik dhe qindra të tjerë marrin lëndime të rënda apo të lehta trupore. Nënkoloneli Jeton Rexhepi, drejtor i Divizionit të Komunikacionit nga Policia e Kosovës, ka thënë se këtë vit, me gjithë numrin e aksi-

Infrastrukturës dhe Transportit (MIT), e përfaqësuar nga Fejzulla Mustafa, drejtor i Departamentit Koordinues të Këshillit për Sigurinë e Komunikacionit Rrugor dhe Avdyll Ymeri, drejtor i Departamentit të Menaxhimit të Rrugëve, vlerësuan lart bashkëpunimin e të gjitha institucioneve relevante për ruajtjen e sigurisë rrugore dhe zvogëlimin e

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Si pasojë e aksidenteve në trafik, që nga mbarimi i luftës (1999-2019) në Kosovë kanë humbur jetën 2 523 persona. Këto të dhëna janë publikuar të premtën nga Policia e Kosovës në kuadër të shënimit të Ditës Botërore të Përkujtimit të

FSK-së i shtohen edhe 337 pjesëtarë të rinj



PRISHTINË, 15 NËNTOR (ER) - Në kazermën "Adem Jashari" të Forcës së Sigurisë të Kosovës në Prishtinë të premtën është mbajtur ceremonia e betimit të 337 rekrutëve të rinj, gjenerata e dytë e FSK-së, pas përfundimit

të trajnimit bazik nëntëjavësh në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj. Në ceremoninë e betimit ishin të pranishëm: zëvendësministri e Mbrojtjes Burim Ramadani dhe Kadri Kastrati,

komandanti i FSK-së, gjeneral-allejtënant Rrahman Rama, gjeneralë, oficerë dhe nënoficerë të FSK-së, atashë ushtarakë, përfaqësues të NALT-it, përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe publike, si dhe

familjarë të rekrutëve dhe mysafirë të shumtë. Betimin e kanë dhënë 337 rekrutë të rinj, prej tyre 251 meshkuj, 47 femra dhe 38 pjesëtarë nga radhët e komuniteteve joshumicë.

Komandanti i FSK-së, Rrahman Rama, ka thënë se kjo forcë tani ka kapacitetet e duhura, përmes të cilave mund t'i bashkohet edhe NATO-s. "Ju zgjodhët një profesion fisnik për t'iu shërbyer qytetarëve të Kosovës. FSK-ja ka vajzat dhe djemtë më të mirë të këtij vendi. Ne jemi të gatshëm për paqe dhe stabilitet. Ne sot kemi kapacitetet e duhura që mund t'i bashkohemi edhe forcave të ushtrisë ndërkombëtare siç është ajo e NATO-s. Të jeni të zellshëm dhe me integritet. Dhe, respektojini urdhrat. Vetëm në këtë mënyrë do t'i bëni nder FSK-së dhe do ta bëni krenar secilin qytetar të Kosovës. Urime certifikimi dhe fat në forcat ushtarake!", ka thënë Rama.

Mbahet tryeza për gjendjen e tanishme dhe të ardhmen e kërkimit dhe inovacionit në Kosovë

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë organizoi tryezën me temë "Status quo e zhvillimit të kërkimit dhe inovacionit në Kosovë: ide rreth së ardhmes së K&I në Kosovë", mbështetur nga Projekti HERAS (Higher Education, Research and Applied Sciences), i cili përkrahët nga Qeveria e Austrisë.

Qëllimi i kësaj tryeze ishte prezantimi i status quos së kërkimit dhe zhvillimit të inovacionit në Kosovë, ku edhe u publikua raporti i Vlerësimit të Kërkimit dhe Inovacionit (K&I),

duke specifikuar hapësirat për përmirësim në relacion me Zonën Evropiane të Kërkimit si dhe ofrimin e një sërë rekomandimesh për avancimin e K&I në Kosovë në të ardhmen. Sekretari i përgjithshëm i MASHT-it, Ekrem Kastrati, ka thënë se Ministria e Arsimit mbetet e përkushtuar që të angazhohet maksimalisht për realizimin me sukses të Projektit HERAS në Kosovë, me qëllim të zhvillimit të kërkimit dhe inovacionit në Kosovë.

Sekretari Kastrati vlerësoi kontributin e çmuar të Austrisë në këtë drejtim, ndërsa theksoi se mbetet që në të ardhmen të jetësohen konkluzionet dhe



rekomandimet që dalin nga dokumenti i prezantuar, me qëllim të përmirësimit të sistemit të K&I në Kosovë dhe përgatitjes së vendit për integrim në Zonën Evropiane të Kërkimit (ERA). Ambasadori i Austrisë në Kosovë,

Christoph Weidinger, tha se është i kënaqur që Austria është ndër vendet kryesore të BE-së që për njëzet vjet mbështet zhvillimin e arsimit të lartë dhe kërkimin e inovacionit në Kosovë përmes projekteve të ndryshme.

Në këtë tryezë morën pjesë studiues, përfaqësues të institucioneve si dhe përfaqësues të organizatave vendore dhe ndërkombëtare që përkrahin zhvillimin e kërkimit dhe inovacionit.

Oda Ekonomike e Kosovës thotë se ka organizuar me sukses 'Panairin e Tregtisë Inverse'

PRISHTINË, 15 NËNTOR (ER) - Oda Ekonomike e Kosovës përmes një njoftimi për media ka bërë me dije se ka organizuar me sukses "Panairin e Tregtisë Inverse". "Panairi është mbajtur në kuadër të projektit 'Nxitja e transformimit digjital të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme', i përkrahur nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë. Në këtë panair ekspozuesit (bizneset e mëdha) patën rastin t'i prezantojnë kërkesat e tyre për mallrat dhe shër-

bimet që ata duan të blejnë. Ndërsa si vizitorë të panairit invers të tregtisë ishin bizneset lokale nga sektori i shërbimeve, prodhimit, agrobiznesit etj. të cilët ofruan produktet e tyre për shitje, kompani të vogla dhe të mesme", është thënë në njoftimin për media të OEK-ut. Sipas kësaj ode, qëllimi i këtij panairi ishte që ta rrisë konkurrueshmërinë e ekonomisë vendore duke e bërë atë më tërheqëse dhe njëherësh, duke mbështetur

zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme si dhe të prodhuesve në përgjithësi. "Përmes kësaj ngjarje OEK-u ka synuar të kontribuojë në të mirë të ngritjes së shkallës së përgatitjes dhe zhvillimit të kompanive vendore dhe zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ekonomike dhe tregtare të tyre në mes vete, që i shërbejnë interesit të përbashkët të dy palëve", është thënë në njoftimin e Odës Ekonomike të Kosovës.



ODA EKONOMIKE
E KOSOVËS | KOSOVA CHAMBER
OF COMMERCE

Qendra për Shërbim të Tatimpaguesve në Prishtinë ka realizuar 73 014 aktivitete



PRISHTINË, 15 NËNTOR (ER) - "Shërbime profesionale, efikase dhe transparente për tatimpaguesit janë ndër prioritetet kryesore të Administratës Tatimore të Kosovës. Qendra për Shërbim të Tatimpaguesve funksionon në të gjitha drejtoritë rajonale të ATK-së, e cila brenda strukturës së vet përbëhet nga tri njësi organizative: atë të shërbimeve të drejtpërdrejta për

tatimpaguesit, këshilltarëve tatimorë, si dhe zyrtarët e kontributeve pensionale" është thënë në komunikatën për media të dërguar nga ATK-ja. Sipas kësaj komunikate, qëllimi dhe fushëveprimi i kësaj qendre është krijimi dhe menaxhimi i politikave si dhe strategjive për ofrimin e shërbimeve sa më kualitative në kohë dhe me saktësi për tatimpaguesit. "Qendra

për Shërbim të Tatimpaguesve në Prishtinë vetëm gjatë periudhës janar - tetor 2019 ka realizuar 73 014 aktivitete, përfshirë këtu kërkesa për numër fiskal, regjistrim në TVSh, kërkesa për regjistrim në TAP dhe TAK, kërkesa për vërtetime tatimore, kërkesa për pajisje fiskale, kërkesa për marrëveshje për pagesë, këshilla ligjore etj", thuhet në njoftimin e ATK-së, duke u shtuar

se ATK-ja çdoherë punon për edukimin e tatimpaguesve, rreth ligjeve dhe procedurave tatimore, në mënyrë që tatimpaguesit të informohen në kohë për obligimet që kanë si rezultat i aktiviteteve që zhvillojnë. "Komunikimi i ATK-së me tatimpaguesit zhvillohet në mënyra të ndryshme, duke filluar nga materialet informuese, seminarët e rregullta, takimet e

ndryshme, kontaktimi nga Qendra e Thirrjeve dhe shumë mënyra të tjera përmes të cilave konsiderojmë se informacionet nga ATK-ja janë më afër tatimpaguesve. ATK në vazhdimësi është e përkushtuar që t'i përmirësojë shërbimet ndaj tatimpaguesve në mënyrë që t'ua bëjë më të lehtë deklarimin dhe pagesën e tatimeve", është thënë në komunikatën e ATK-së.

Konsumi i energjisë elektrike në Kosovë shënoi rritje për 11.80 për qind

PRISHTINË, 15 NËNTOR (ER) - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar "Bilancin e Energjisë" për tremujorin e tretë të vitit 2019. Sipas këtij raporti, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2019 (TM3 2019) vlera e gjithëmbarshme e prodhimit të thëngjillit ishte rreth 1.84 mijë

ton, kurse sasia bruto e energjisë elektrike, e prodhuar në termocentrale, ishte 1 338.1 GWh, ndërsa në hidrocentrale ishte rreth 79.2 GWh. Sa iu përket vlerave të energjisë së importuar, respektivisht të eksportuar, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2019 Kosova ka importuar 410.9 GWh energji

elektrike, kurse ka eksportuar 437.1 GWh energji elektrike. Ndërkaq, sasia e energjisë elektrike për konsum në TM3 2019 ishte 1 034.7 GWh energji elektrike. Në raport me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar (TM3 2018) sasia e energjisë elektrike e konsumuar është rritur për 11.80 për qind.



Nënshkruhen gjashtë udhëzime administrative nga fusha e kadastrës dhe regjistrimit të pronës

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Në një ceremoni të organizuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, ka nënshkruar gjashtë Udhëzime Administrative nga fusha e kadastrës dhe regjistrimit të pronës, të cilat, siç u tha edhe nga vetë ministri Matoshi, do ta ngritin kualitetin e produkteve dhe shërbimeve kadastrale dhe pronësore që Agjencia Kadastrale e Kosovës, Zyrat Kadastrale Komunale dhe Kompanitë e licencuara gjeodete dhe gjeodetët e licencuar ua ofrojnë qytetarëve dhe institucioneve të Republikës së Kosovës.

Pas nënshkrimit të këtyre Udhëzimeve Administrative, ministri Matoshi përmendi

disa prej përfitimeve të menjëhershme për qytetarët, duke veçuar shmangien e procedurave burokratike, standardizimin e çmimeve për produkte dhe shërbime kadastrale të cilat ofrohen nga Zyrat Kadastrale Komunale, kompanitë e licencuara gjeodete dhe gjeodetët e licencuar dhe nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, krijimin e bazës ligjore për ofrimin e produkteve online, pastaj lehtësim në ndarje e bashkim të parcelave nga pronarët e ngjashëm. "Me nënshkrimin e këtyre udhëzimeve administrative janë standardizuar çmimet për produkte dhe shërbime të cilat u ofrohen qytetarëve, janë ngritur kriteret për licencim të gjeodetëve dhe kompanive gjeodete, paralelisht me këto edhe kualiteti i shërbimeve ndaj qytetarëve. Po ashtu, do të eliminohen pengesat për ndarjen dhe bashkimin

e parcelave në zonat urbane", tha Matoshi.

Kryeshefi ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Avni Ahmeti, tha se që nga marrja e mandatit të kryeshefit ekzekutiv ka qenë i angazhuar për identifikimin e sfidave në fushën e kadastrës, gjeodezisë dhe të drejtave pronësore, si dhe për gjetjen e mjeteve për tejkalimin e këtyre sfidave. "Gjatë këtij viti, përveç projekteve kapitale, kemi finalizuar draftet për dy projektligje që rregullojnë fushën e kadastrës dhe administrimit të tokës, respektivisht Ligjin për Kadastër dhe Ligjin për Infrastrukturën e të Dhënave Hapësinore, si dhe kemi avancuar 11 akte nënligjore, 6 prej të cilave po nënshkruhen sot dhe kanë të bëjnë me fushën e kadastrës dhe gjeodezisë dhe 5 të tjera që e mbulojnë fushën e regjistrimit dhe sistemit të

adresave e që besoj se do të nënshkruhen në ditët në vijim", tha Ahmeti duke theksuar se ka edhe besim që Qeveria në ardhje do ta përkrahë Agjencinë me shtyrjen përpara të dy projektligjeve të përmendura më sipër. "Ligji i ri për kadastër parashih riorganizimin e sistemit kadastral në nivel vendi, ndërsa ky riorganizim do të shënojë një kapitull të ri për kadastrën e Kosovës, pra një reformë rrënjësore, duke mundësuar ofrimin e shërbimeve më cilësore për qytetarët dhe duke ulur në minimum mundësinë për keqpërdorim të detyrës zyrtare, duke eliminuar dukuritë negative sikurse është korrupsioni", ka thënë Ahmeti.

Draftimi i këtyre udhëzimeve administrative i është nënshtruar një procesi gjithëpërfshirës mes ekspertëve vendorë e ndërkombëtarë, me përfshir-

jen e Shoqatës së Gjeodetëve të Kosovës, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrinë e Drejtësisë, Odën e Avokatëve dhe atë të Noterëve, si dhe pas diskutimeve me ekspertë nga Banka Botërore, USAID-in dhe ekspertët norvegjezë.

Udhëzimet Administrative të nënshkruara janë: Udhëzimi Administrativ për ndarjen dhe regjistrimin e parcelës, Udhëzimi Administrativ për matjet kadastrale për regjistrim në kadastër, Udhëzimi Administrativ për ndarjen e ndërtesës dhe pjesëve të ndërtesës, Udhëzimi Administrativ për ndarjen e zonave kadastrale, Udhëzimi Administrativ për licencimin e kompanive gjeodete dhe të gjeodetëve si dhe Udhëzimi Administrativ për tarifën dhe produktet e Agjencisë Kadastrale.

Arrestohet një person për shmangie nga tatimi, nuk pagoi mbi 700 mijë euro

Prishtinë, 15 nëntor (ER) - Më 23.04.2019 në Drejtorinë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit (DHKEK) është pranuar informata se një i dyshuar është duke kryer veprën penale 'shmangie nga tatimi'. Pas analizimit të informatave nga hetuesit e DHKEK-së janë ndërmarrë të gjitha veprimet

hetimore dhe në bashkëpunim me zyrtarët e ATK-së është vërtetuar se i dyshuari i lartcekur ka kryer veprën penale në periudhën kohore 2015-2016, duke dëmtuar në këtë mënyrë buxhetin e Kosovës prej 744,321.91 eurosh.

Sipas një njoftimi të Policisë së Kosovës, personi i dyshuar i

arrestuar lidhur me këtë rast është A. M., lindur më 1986. "Sot, më 15 nëntor 2019, pas intervistimit të të dyshuarit të lartcekur, në konsultim dhe me urdhër të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, të dyshuarit të lartcekur i është caktuar masa e ndalimit prej 48 orëve", thuhet në këtë njoftim.



Haziri takohet me kryetarë të disa komunave nga Polonia

GJILAN, 15 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, i shoqëruar nga kryetari i Parteshit dhe ai i Ranillugut, kanë pritur në takim pune një delegacion të kryetarëve të disa komunave nga Polonia dhe përfaqësues të disa ndërmarrjeve të parkut industrial, të udhëhequr

nga Krzysztof Sobejko, kryetar i Komunës Lezajsk, Adam Wylaz, kryetar i regjionit Lezajskog, në të cilin përfshihen disa komuna dhe Zofia Novak, kryesuese e Kuvendit të Komunës Trinça. Qëllimi i takimit ka qenë koordinimi për bashkëpunim i Gjilanit, Parteshit e Ranillugut me

komunat polake. Kryetari Haziri, pasi i ka falënderuar kryetarët e komunave polake për vizitën, ka njoftuar se gjatë muajve në vazhdim do të konkretizohet bashkëpunimi komunal në fushën e arsimit, kulturës dhe zhvillimit ekonomik lokal në veçanti.



Pastrohet ambienti përreth liqenit në Mirushë

MALISHEVË, 15 NËNTOR (ER) - Organizuar nga Shoqata e Peshkatarëve Sportivë "Sykuqi" në Malishevë, në bashkëpunim të ngushtë me Komunën e Malishevës, njësinë e kompanisë për menaxhimin e mbeturinave "Ekoregjioni" në Malishevë, njësinë e zjarrfikësve në Malishevë dhe nxënësit e shkollës "Labinot Krasniqi" në Mirushë, është pastruar ambienti përreth liqenit në Mirushë. Në këtë aksion morën pjesë edhe kryetari i Komunës së

Malishevës, Ragip Begaj, nënkryetari Hajdin Berisha, drejtorë të drejtorive përkatëse komunale, inspektorët komunalë, si dhe kryetari i Federatës së Peshkatarëve të Kosovës, Bashkim Krasniqi. Kryetari Begaj i ka përkrahur vullnetarët dhe të gjithë që kanë marrë pjesë në këtë aksion, i cili ka domethënie të madhe jo vetëm për pastrimin e ambientit, por edhe për vetëdijesim për mbrojtje të ambientit. Në veçanti, kryetari Begaj i ka falënderuar nxënësit e shkollës në Mirushë.

Ambienti përreth liqenit në Mirushë, ndonëse jo shumë i ndotur, në vazhdimësi mbikëqyret nga Shoqata e Peshkatarëve "Sykuqi" në Malishevë, të cilët, krahas aktiviteteve të përditshme, organizojnë edhe aksione të pastrimit të ambientit. "I falënderoj të gjithë për pjesëmarrje në këtë aksion dhe, në të njëjtën kohë, u bëj thirrje të gjithë atyre që e vizitojnë liqenin, ta ruajnë ambientin", ka thënë kryetari i Shoqatës së Peshkatarëve "Sykuqi", Avdullah Paçarizi.

Panairi bën bashkë gratë ndërmarrëse të Vitisë dhe të Dragashit

VITI, 15 NËNTOR (ER) - Në kuadër të "Javës së Ndërmarrësisë" në Viti është mbajtur të premten një panair në të cilin janë ekspozuar produktet prodhuese dhe veprimtari të tjera biznesore nga gratë e kësaj komune dhe të Komunës së Dragashit. Ky aktivitet është organizuar në kuadër të projektit "Zhvillimi i integruar territorial (Interdev 2)", financuar Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) dhe implemtuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Në emër të institucioneve komunale, të pranishmit i ka përshëndetur nënkryetari i Vitisë, Hasan Aliu, i cili ka uruar gratë për punën e

vazhdueshme që janë duke bërë. Ai i ka inkurajuar organizatorët e ngjarjeve të këtilla, që jo vetëm në javën e ndërmarrësisë, por edhe në ditët e tjera të organizohen aktivitete të kësaj natyre. Kurse Arsim Haziringa nga ADA-ja ka vlerësuar bashkëpunimin me Komunën e Vitisë dhe UNDP-në, duke u zotuar se edhe në të ardhmen do t'i mbështesin iniciativat që kanë për interes avancimin e grave.

Në këtë panair është folur edhe për parandalimin e dhunës ndaj gruas.

Në Komunën e Vitisë veprojnë 1 845 biznese me veprimtari të ndryshme, ku pesë për qind e tyre udhëhiqen nga gratë.



Ahmeti prezanton projektet e realizuara në Hajvali

PRISHTINË, 15 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, përmes një postimi në llogarinë e vet në 'Facebook' ka treguar se në rrugën kryesore të fshatit Hajvali projekti ka përfunduar me sukses. "Rruga

kryesore e fshatit Hajvali është edhe një investim dhe projekt infrastrukturor i rëndësishëm i realizuar me sukses. Punimet dhe sinjalizimi në rrugën 'Dëshmorët e Gollakut' kanë përfunduar", ka shkruar Ahmeti.

ShSKUK-ja, investime moderne në Spitalin e Mitrovicës

MITROVICË, 15 NËNTOR (ER) - Spitali i Përgjithshëm i Mitrovicës po krijon hapësirë të re për Njësinë e Sterilizimit, e cila deri tash ka funksionuar në kushte të rënda.

Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka ndarë mjete të mjaftueshme që sterilizimi të ketë një infrastrukturë dhe pajisje moderne.

Një prej tyre është edhe sterilizatori me avull i teknologjisë së fundit, me një kapacitet prej 60 litrash. Pranë saj janë vendosur dhomat e zgjimit dhe hapësirat për mjekët anesteziologë. Punimet janë në fazën përfundimtare dhe pritet të kryhen shpejt.



Gjykata Speciale po i fyen dhe poshtëron viktimat e luftës, dëshmitarët dhe institucionet e Kosovës



Nga Musa SABEDINI

Ani pse Gjykata Speciale është krijuar me pëlqimin e institucioneve të Kosovës, gjuetia që po bën ajo në ditët e fundit, duke mos zgjedhur asnjë të dyshuar të mundshëm, tregon se sa e padrejtë është ajo në raport me qytetarët e Kosovës, derisa mijëra shqiptarë të vrarë e të dhunuar nuk e kanë asnjë të mundësi për të kërkuar drejtësi. Asnjë serb nuk është dënua nga ndonjë gjykatë ndërkombëtare përkundër qindra krimeve të kryera ndaj shqiptarëve në Kosovë. Madje dyshoj se kjo do të ndodhë ndonjëherë nga drejtësia ndërkombëtare. Kjo nuk nënkupton se unë po mbroj individët që po kërkohen nga Specialja, por është e qartë se dëmi i tyre është periferik kraha-

suar me krimet e shumta që kanë bërë serbët ndaj civilëve shqiptarë. Gjykata Speciale po e turpëron një popull të tërë, po e përlyen një luftë e cila, hiq ndonjë gabim eventual që ka mundur të ndodhë, ishte e drejtë, ishte luftë vetëmbrojtëse nga forcat kriminale të Millosheviqit.

Gjykata Speciale u krijua nga institucionet e Kosovës dhe të gjitha hetimet, fatkeqësisht, janë zhvilluar mbi deklaratat e dhëna nga dëshmitarë shqiptarë, por edhe serbë. Nuk e kam hallin pse po ftohen kaq shumë liderë e komandantë ushtarakë nga kjo Gjykatë. Halli është te nënshtrimi dhe poshtërimi që kjo Gjykatë po i bën Kosovës, viktimave të luftës, grave e vajzave të dhunuara. Për më tepër, kjo Gjykatë po e keqpërdor skajshmërisht mandatin e saj. Drejtësia ka fjetur mbi dosjet e luftës në Kosovë dhe s'është marrë me krimet e forcave serbe, ende asnjë aktakuzë dhe asnjë dënim as pas 20 vjetësh. Pse ka

ndodhur kjo, faji është edhe yni. Është yni sepse pas luftës kishte media dhe politikanë që donin me çdo kusht ta pengonin hapjen e dosjeve të krimeve serbe në Kosovë.

Heshtja në emër të qetësisë politike

Personalisht asnjëherë s'jam ndalur duke shkruar për krimet e forcave serbe, madje kam botuar edhe librin "Vrasje dhe dëshmi", por te shtresa intelektuale dhe politikanët e sotshëm nuk pëlqejnë kjo gazetari "agresive" sepse, sipas tyre, nuk duhej trazuar qetësinë politike në Kosovë. Edhe nëse do të ndiqeshin penalisht të dyshuarit e mundshëm shqiptarë nga gjykata, kjo do të ishte periferike në krahasim me krimet e shumta që ka bërë Serbia. Do të ishte e pandershme të akuzosh një komandant shqiptar, i cili tek e fundit luftën e ka zhvilluar në vetëmbrojtje. Por, është e pafalshme ta injorosh një krim e gjenocid që ka ndodhur

para syve të tërë botës dhe që i dëshmuar me të dhëna, fakte, dokumente, dëshmi e deklarata rrëqethëse të dëshmitarëve, fotografi nga vendi i krimit. Gjykata Speciale, realisht u krijua për shkak edhe të paaftësisë së organeve të drejtësisë në Kosovë. Asnjë prokuror nuk e pati guximin që as pas 20 vjetësh, të paktën të lëshojë fletë arreste ndërkombëtare për serbët e dyshuar. Prokuroritë kosovare janë duke fjetur mbi dosjet e dëshmitarëve dhe ekipeve të ndryshme nga tereni. Evropa nuk po e përmbush një standard të njohur ndërkombëtar që thotë "drejtësi për të gjithë dhe drejtësi për të gjitha palët e përfshira". Ne jemi viktimat në çdo kohë kur flitet për krimet e ndodhura në Kosovë. Fatkeqësisht, Serbia ka arritur që përmes propagandës, ta shndërron veten në viktimë, duke qenë agresor dhe kriminel. Ajo ende po e luan këtë rol, i cili po i kushton Kosovës në të gjitha takimet e saj në raport me Serbinë. Çfarë duhet të bëjmë?

Edhe pse kanë kaluar 20 vjet nga lufta, nuk është vonë ende që të deponohen kallëzime penale në prokurori, polici e gjykata, të ofrohen materiale dokumentuese, fotografi e incizime të ndryshme, emra dhe lista të forcave serbe, që janë zënë në istikame. Dosjet e kompletuara duhet të dërgohen në të gjitha prokuroritë kosovare. Pavarësisht se prokurorët mund të heshtin sërisht, kam bindjen se do të dalë ndonjë prokuror që ka guximin t'i shtyjë përpara dosjet e krimeve. Individualisht kemi folur e kemi shkruar gjatë, në shqip e anglisht, për krimet serbe, por kemi heshtur si shoqëri sepse nuk i kemi nxitur palët e dëmtuara që t'u drejtohen organeve të drejtësisë. Në emër të drejtësisë, andaj duhet ta bëjmë këtë lëvizje, që të kërkojmë zyrtarisht emrat e serbëve të dyshuar.

(Autori është ligjërues në degën e Medias dhe Komunikimit në UBT dhe themelues i portalit "Rajonipress")

'Minishengeni' dhe paaftësia jonë



Dr. Fidan MUSTAFA

Debatet e fundit rreth iniciativës së një minishengeni ballkanik, veçmas nga vendet joanëtare të BE-së, ka ngjallur reagime dhe opinione të ndryshme të pala shqiptare. Gjykimet rreth kësaj iniciative deri tani janë të natyrës më shumë personale sesa te përmbajtja dhe mundësitë që sjell kjo iniciativë në të ardhmen për shqiptarët në përgjithësi. Te pala kosovare opinioni i përgjithshëm bazohet te protagonistët e kësaj iniciative dhe frika nga paaftësia për t'u ballafaquar në të ardhmen në tryezën e këtyre diskutimeve. Argumentet e sjella nga figurat politike në Kosovë argumentojnë gjoja se ky minishengeni i hap rrugën një "jugosllavie" të re në Ballkan dhe se orientimi i vetëm i Kosovës është BE dhe NATO. Sipas presidentit të vendit, z. Hashim Thaçi ndihet i tradhtuar nga homologët e vet, presidenti Vuçiq dhe kryeministri Rama, për anashkalim gjatë takimit të parë me Serbinë. Së dyti, sipas presidentit Thaçi, Kosova synon vetëm anëtarësim në BE dhe NATO çka, në fakt, demanton gjithë rrugëtimin e tij politik të deritanishëm në raport me bisedimet me presidentin e

Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në mes të Kosovës dhe Serbisë. Për ish-kryeministrin Isa Mustafa, njëherësh kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, iniciativa e minishengenit çon rajonin drejt "Jugosllavisë" së re pa Kroacinë, por me Shqipërinë. Ndërkaq, kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, z. Albin Kurti, iniciativën për minishengen e sheh si një proces të nevojshëm, por me korrigjim të hapave drejt kësaj iniciative. Sipas tij, ky proces duhet të fillohet nga Shqipëria e Kosova, pastaj vendet e tjera të rajonit dhe krejt në fund edhe Serbia. Për sqarim të opinionit shqiptar, Kosova tashmë ka marrëveshje për lëvizje të mallrave me gjitha vendet e rajonit përmes marrëveshjes CEFTA. Gjithashtu, Kosova ka marrëveshje të lëvizjes së lirë të qytetarëve të saj me Serbinë, Maqedoninë Veriore dhe Shqipërinë. Ku kufiri kalohet vetëm përmes letërnjoftimeve të këtyre vendeve. Po ashtu, në prill të këtij viti 2019, Shqipëria, Kosova, Maqedonia Veriore, Bosnja e Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia arritën edhe një marrëveshje tjetër në gjithëpërfshirje të interesave ballkanike, atë të fushës së telekomunikacionit. Një marrëveshje për heqjen e çmimeve të shërimin roming. Me fjalë të tjera, "minishengeni" ballkanik tashmë ekziston në të gjitha marrëveshjet e vendeve të rajonit. Ajo çdo ditë gjen zbatimin e saj para syve tanë dhe pikërisht këto marrëveshje janë nënshkruar nga protagonistët e

njëjtë që sot po kundërshtojnë një iniciativë të tillë. Këto marrëveshje sot janë të pranishme me nënshkrime të presidentit aktual Hashim Thaçit, ish-kryeministrin Isa Mustafa dhe dhjetëra figurave të tjera nga delegacionet e Kosovës gjatë dekadës së fundit.

Çka humb Kosova nga kjo mospjesëmarrje?

Së pari, kundërshtimi i idesë duhet të vijë brenda tryezës jo nga pozicioni i spektatorit, pasi që një pozicion i tillë nga ana e Kosovës krijon hapësirë për përfaqësim nga të tjerët, prandaj edhe treshja, Vuçiq, Rama dhe Zaev, prezantuan hartën e këtij "minishengeni" pa Kosovën si shtet. Sikurse të ishte përfaqësimi i Kosovës aty, ky fakt do të eliminonjë fillimisht: Së dyti, përmes kësaj tryeze duhet të kërkohet që Kosova të përfaqësohet si palë e barabartë shtetërore, ku flamuri, stema dhe harta e Kosovës të jetë të pranishme në çdo takim të ardhshëm; Së treti, duke qenë pjesëmarrës Kosova brenda këtyre iniciativave rajonale, do t'i hapte rrugë që paraprakisht të arrihet marrëveshje me Shqipërinë, Maqedoninë, Malin e Zi dhe, në fund, edhe me Serbinë. Dhe se askush nuk do të kishte të drejtë ta kundërshtonte një vendim të këtillë, as edhe Serbia; Së katërti, Kosova do të futej me të drejta të barabarta, pa devijuar asnjë çast orientimin strategjik të

Kosovës drejt BE-së dhe NATO-s, në partneritet të ngushtë me Shtetet e Bashkuara, madje në anën tjetër do t'i izolonte raportet ruso-serbe për Ballkanin; Së pesti, pjesëmarrja e Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë në këtë format të bisedimeve do ta minimizonte jashtë mase ndikimin serb në rajon. Ndërkaq mospjesëmarrja e Kosovës i ofron Serbisë shfaqësimin para faktorit ndërkombëtar dhe të 'drejtën' që Kosovën ta prezantojë si pjesë integrale të saj siç edhe ndodhi; Së gjashti, pjesëmarrja e Kosovës në "minishengenin" e mundshëm nuk i rrezikon asnjë lloj të drejte për vendosjen e masave të reciprocitetit me Serbinë, përkundrazi mendoj se vetëm do ta fuqizonte më tej një vendim të tillë në rast se do të kërkonte nevojën. Si përfundim, fitoret politike nuk arrihen përmes bojkoteve dhe vetizolimeve. Fitoret politike e diplomatike arrihen përmes vizionit, urtësisë dhe largpamësisë shqiptare për dekadat e ardhshme. Sot Serbia çdo vit humb rreth 70 000 qytetar nga disproporcioni i natalitetit me mortalitetin. Shqiptarët në Ballkan, përkundër rënieve, ende kanë një natalitet vjetor prej 50 000 lindjesh dhe me një politik ma objektive këtë natalitet shqiptarët do të shtonin edhe më shumë. Droja nga një "Jugosllavi e re" është jashtë çdo logjike dhe përfundimi praktik. Për faktin sepse kur u formua Jugosllavia e parë dhe e dytë, Kosova nuk përfaqë-

onte asnjë element kombëtar para faktorit të jashtëm dhe ishte plotësisht e shkapërderdhur, Shqipëria ishte e minuar nga mendësitë e ngushta politike të brendshme, ndërsa shqiptarët e Maqedonisë së atëhershme ishin po ashtu të nënshtruar në çdo aspekt. Pas kaq dekadash, sot pozicioni shqiptar në rajon është i jashtëzakonshëm në gjitha aspektet. Sot kemi dy shtete e tri parlamente shqiptare. Sot kemi një mërgatë rreth 12 milion shqiptarësh që janë një fuqi e madhe ekonomike, diplomatike e politike. Sot shqiptarët kanë një pozicion të jashtëzakonshëm gjeopolitik e gjeostrategjik. Shqipëria përfaqëson bazën më të madhe ajrore të NATO-s në Ballkan dhe Evropë përmes asaj të Kuçovës, ndërsa Kosova përfaqëson bazën më të madhe të NATO-s në Ballkan dhe bazën më të madhe Amerikane gjithashtu. Sot shqiptarët kanë një pozicion të jashtëzakonshëm gjeostrategjik e gjeopolitik. E vetmja gjë që kërkohet nga lidhshipi shqiptar është: Të mendojmë racionalisht, larg agjendave politike, me maturi, urtësi dhe të formohen projektet gjeostrategjike për shqiptarët ballkanik që do t'i nevojiten në shekullin XXI. E ardhmja i takon vizionarëve, e kaluara i takon kritikëve partiak për mbijetesë politike.

(Njohës i zhvillimeve gjeopolitike e gjeostrategjike për Ballkan, me objektiv shqiptarët e shekullit XXI)

Hetime ndaj Rudy Giulianit, avokatit të Trumpit

UASHINGTON, 15 NËNTOR - Prokurorët federalë kanë hapur një hetim ndaj Rudy Giulianit, avokatit personal të presidentit Donald Trump, njoftoi rrjeti televiziv Bloomberg. Prokurorët po hetojnë për shkelje të mundshme të ligjit për financimin e fushatave elektorale, si dhe faktin që Giuliani nuk u regjistrua si një

agjent i huaj, thuhet në artikullin e rrjetit Bloomberg. Giuliani, ish-kryebashkiaku i Nju Jorkut, është shfaqur si një personazh kryesor në hetimet për shkarkimin e presidentit Trump. Ligjvënësit po shqyrtojnë ndër të tjera se çfarë roli luajti Giuliani në presionin ushtruar presidentit të Ukrainës, Volodymyr Zelensky, që t'i het-

onte rivalët e presidentit Trump. Mimi Rocah, ish-prokurore federale me Prokurorinë e Distriktit Jugor të Nju Jorkut i tha rrjetit Bloomberg, se ajo nuk do të befasohej nëse ndaj Giulianit ngrihen akuza si rezultat i këtij hetimi federal. "Është e qartë se Giuliani është i zhytur thellë në gjëra të errëta", tha ajo.



Ish-ambasadorja në Ukrainë dëshmon në hetimet ndaj Trumpit

Ish-ambasadorja amerikane në Ukrainë, Marie Yovanovitch tha se janë të pavërteta pohimet se ajo u ka thënë punonjësve të pidentifikuar të Ambasadës ose zyrtarëve të Ukrainës që urdhrat e presidentit Trump duheshin injoruar sepse ai do të fajësohej ose për ndonjë arsye tjetër

UASHINGTON, 15 NËNTOR - Të premtën, para Komitetit për Inteligjencë të Dhomës së Përfaqësuesve, ka nisur dëshminë, ish-ambasadorja amerikane në Ukrainë, Marie Yovanovitch.

Gjatë fjalës hyrëse, ajo ka kundërshtuar disa nga akuzat që janë bërë në drejtim të saj. Ajo tha se janë të pavërteta pohimet se ajo u ka thënë punonjësve të pidentifikuar të Ambasadës ose zyrtarëve të Ukrainës që urdhrat e presidentit Trump duheshin injoruar sepse "ai do të fajësohej"- ose për ndonjë arsye tjetër, ka njoftuar rfe.

"Unë nuk e bëra dhe nuk do ta thosha një gjë të tillë. Deklarata të tilla do të ishin në kundërshtim me trajnimin tim si oficer i Shërbimit të Jashtëm dhe rolin tim si ambasador", tha ajo.

Ajo më tutje theksoi se Rudy Giuliani, avokat personal i presidentit dhe bashkëpunëtorët e tij drejtuan kundër saj një fushatë dezinformimi. Ajo shtoi se këto ngjarje duhet të shqetësojnë të gjithë në këtë dhomë. Derisa ish-ambasadorja po jepte dëshminë e saj, presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump shkroi në rrjetin social Twitter, se kudo që ajo ka shkuar gjatë karrierës së saj "është bërë keq".

Dhoma e Përfaqësuesve po e heton presidentin Trump nëse

ai ka abuzuar detyrën e tij për përfitime personale dhe politike, duke nxitur një qeveri të huaj për të hetuar rivalët e tij politikë. Në veçanti, nëse Trumpi pezulloi 390 milionë dollarë ndihmë ushtarake për Ukrainën dhe i kërkoi presidentit të Ukrainës, Volodymyr Zelenskiy që të zhvillojë hetime ndaj kundërshtarit të tij të mundshëm në zgjedhjet presidenciale të vitit 2020, ish-nënpresidentit amerikan Joe Biden dhe djalit të tij, Hunter.

Procesi hetimor ndaj Trumpit po zhvillohet i hapur për publikun.

Në hapje të seancës, kryesuesi i Komitetit, Adam Schiff tha se ambasadorja Yovanovitch jo vetëm që hidhëroi ukrainasit e korruptuar, si ish-prokurori i përgjithshëm i korruptuar Yuri Lutsenko, por edhe disa amerikanë si Rudy Giuliani, avokat personal i presidentit Donald Trump dhe dy individë, të paditur tani, që kanë punuar me të, Igor Fruman dhe Lev Parnas.

Kongresisti republikan, Devin Nunes akuzoi demokratët për operacionin e tyre për të rrëzuar një president të zgjedhur sipas rregullave. Ai gjithashtu tha se seancat dëgjimore në kuadër të hetimit e kanë bllokuar punën legjislative të Kongresit. Ai akuzoi demokratët për "fantazitë e Watergate" duke iu referuar



hetimit mbi presidentin Richard Nixon në vitet 1970.

Në kohën kur po fillonte seanca në Dhomën e Përfaqësuesve, Shtëpia e Bardhë e ka publikuar transkriptin e bisedës së parë ndërmjet presidentit të ShBA-së, Donald Trump dhe homologut të tij ukrainas, Volodymyr Zelensky.

Trumpi fillimisht e uron Zelenskyn për fitoren në zgjedhje. "Kanë qenë zgjedhje të jashtëzakonshme", i thotë Trumpi homologut Zelensky.

Presidenti Trump kishte premtuar

se do ta publikojë bisedën e parë telefonike, të zhvilluar në muajin prill.

Mirëpo, një bisedë e muajit korrik me presidentin Zelensky është arsyeja që Dhoma e Përfaqësuesve ka nisur procedurën e shkarkimit të presidentit Trump. Një informator, deri më tani i pidentifikuar, dërgoi ankesë duke thënë se biseda përbënte shkelje nga ana e presidentit amerikan.

Mund të ketë seanca të tjera publike të Komitetit të Inteligjencës. Pasi të mbarojnë seancat

dëgjimore publike, Komiteti i Inteligjencës, së bashku me dy komitetet e tjera, pritet të raportojnë për gjetjet e tyre.

Ky raport do t'i dërgohet Komisionit Gjyqësor, i cili pritet të zhvillojë seancat e veta.

Më pas materiali i hartuar nga komiteti do të dërgohet në Dhomën e Përfaqësuesve për votim, që ka gjasa të ndodhë deri në fund të vitit. Gjyqi për të vendosur nëse përfundimisht do të shkarkohet presidenti zhvillohet në Senat, i cili kontrollohet nga Partia Republikane e Trumpit.

Macronit i bie popullariteti

PARIS, 15 NËNTOR - Sipas një studimi të kryer nga Instituti BVA për "Orange", RTI dhe "LaTribune", për presidentin francez, Emanuel Macron ka një rënie të lehtë në indeksin e vlerësimit në muajin nëntor me 36% të opinioneve në favor të tij (minus një pikë), e ndërsa

në anën tjetër për kryeministrin Edouard Philippe, ka një pikë shtesë duke arritur në kuotën 41%.

Pothuaj 64% e personave të intervistuar kanë një mendim negativ për kryetarin e shtetit dhe 58% për kryeministrin. Për 61%, Macron vepron "sipas

momentit", ndërsa 38% mendojnë se "ai e di se ku po shkon".

Të paktën 57% e francezëve besojnë se Macroni dhe qeveria nuk do të marrin rezultate pozitive në fund të periudhës 5-vjeçare të qeverisjes, pra në vitin 2022.





AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

E jashtëzakonshme

Zbulohet kopshti personal i Hitlerit

Historianët kanë zbuluar mbetjet e një kompleksi kopshtarie në të cilën Adolf Hitleri rriste fruta dhe perime. Serrat janë zbuluar në zonën lindore të bazës ku ai qëndronte gjatë Luftës së Dytë Botërore. Sipas tyre, bunkeri i Fyhrerit, i quajtur "Strofulla e Ujku", ka mbetjet e dy serrave dhe të një bodrumi ku kalonte vazhdimisht ujë dhe ajër i ngrohtë, që stafi i tij të kultivonte perime gjatë gjithë vitit.



Vendndodhja e kësaj serre është në atë pjesë që dikur quhej Prusi, rreth 2 kilometra larg bunkerit personal të Hitlerit.

FOTO E DITES



Një i ri palestinez qëndron në kraterin e një shtëpie të shkatërruar pas sulmeve raketore izraelite në Rripin Jugor të Gazës. /AP/

E rrallë

Kërkoni 1 000 euro, çajnikun ua blejnë për 1.1 milion

Një çajnik i rrallë kinez është shitur në ankand për më shumë se 1 milion euro, 1 000 herë më shtrenjtë se ç'e kishin planifikuar shitësit. Çajniku i gjelbër, në formë dardhe, ka vulën e perandorit Kianlog, i cili sundoi në Kinë nga viti 1736 e deri në vitin 1795. Organizuesit e



ankandit e kishin vlerësuar për 1 000 deri në 2 000 euro, por arriti të shitet për rreth 1.1 milion euro brenda 10 minutash.

BARSOLETA E DITËS



Shoferi: Zotëri polic, çfarë je duke bërë?
Polici: Po ta shkruaj një tiketë.
Shoferi: Çfarë tikete?
Polici: Një tiketë të bastores se, siç po duket, nuk paskeni luajtur moti!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjatë vikendit në ora 14:00

ABOMINABLE 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 32 min

Rolet: Chloe Bennet, Tenzing Norgay Trainor, Albert Tsai, Eddie Izzard, Sarah Paulson, Tsai Chin, Michelle Wong, etj.
 Regjia: Jill Culton



Çdo ditë në ora 16:00

TOY STORY 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.
 Regjia: Josh Cooley



Çdo ditë në ora 18:00 dhe 20:00

MALEFICENT MISTRESS OF EVIL 3D

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 orë 58 min

Rolet: Angelina Jolie, Elle Fanning, Chiwetel Ejiofor, Sam Riley, Ed Skrein, Imelda Staunton, Juno Temple, Michelle Pfeiffer, etj.
 Regjia: Joachim Ronning



Çdo ditë në ora 22:00

ZOMBIELAND DOUBLE TAP

Aksion/Komedi/Horror; 1 orë 39 min

Rolet: Woody Harrelson, Jesse Eisenberg, Emma Stone, Abigail Breslin, Rosario Dawson, Zoey Deutch, Luke Wilson, etj.

Regjia: Ruben Fleischer



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: **Kino ABC**.




DASHI

Edhe pse në ambientin e punës mund të keni probleme të vogla, personat që ju rrethojnë nuk kanë qëllime negative karshi jush.



DEMI

Sot do të rriteni shpirtërisht duke dëgjuar muzikë të mirë dhe duke ndenjur në ambiente intelektuale që kishin kohë që ju mungonin.



BINJAKËT

Nëse keni marrë përsipër të përshkoni një rrugë të caktuar nuk duhet të keni më mëdyshje. Çdo kthim pas do t'ju kushtojë.



GAFORRJA

Shumë objektiva tuajat po i anashkaloni vetëm për një hutim të çastit. Do të jetë më mirë të kërkoni këshilla te personat e duhur.



LUANI

Po ju jepen shumë mundësi në karrierë dhe jeni të dyzuar ndërmjet oportuniteteve që do të zgjidhni. Kërkoni mendimin e familjes.



VIRGJËRËSHA

Çdo gjë po shkon më së miri nga ana sentimentale. Ju ndiheni në qiellin e shtatë nga një dhuratë që ju ka bërë partneri.



PESHORJA

Momenti më i mirë i ditës suaj është mëngjesi. Keni kohë të mendoni për çdo gjë dhe jeni më produktiv dhe energjik.



AKREPI

Duhet t'i shfrytëzoni informacionet e reja që do të merrni dhe nuk keni pse merrni kohë që të mendoheni. Çdo gjë ka për të shkuar siç e keni vendosur.



SHIGJETARI

Sot po reflektoni mbi çështje që më parë ju janë dukur shumë të thjeshta. Keni anashkaluar gjëra të rëndësishme që tashmë janë bërë probleme.



BRICJAPI

U bë disa kohë që një person i caktuar po ju bezdis lidhur me një temë që ju nuk dëshironi ta prekni. Sot do të tregoheni shumë i prerë.



UJORI

Sot do të keni surpriza pozitive dhe negative. Keni lënë për shumë kohë pezull një situatë që tashmë ka degjeneruar.



PESHQIT

Nëse doni ta rrisni vetëbesimin e dikujt sot, është mirë ta merrni dhe të diskutoni me qetësi ngjarjet e fundit që i kanë ndodhur.

Taylor Swift thotë se "nuk do t'i lejohej" t'i këndojë hitet në AMA



Këngëtarja Taylor Swift ka thënë se performanca e saj e ardhshme në American Music Awards është vënë në dyshim për shkak se asaj i është ndaluar që t'i këndojë hitet e veta. Përmes një mesazhi në mediat sociale, këngëtarja ka thënë se

menaxherët Scooter Braun dhe Scott Borchetta nuk do t'ia mundësojnë asaj që t'i këndojë këngët nga albumet e mëhershme, për të cilat edhe ata mbajnë të drejta, shkruan "BBC". Ajo ka thënë se edhe dokumentari për të në Netflix është vënë në pikëpyetje.

Cardi B thotë se do t'i falë ata që i luten



Reperja e njohur Cardi B, me anë të një postimi në rrjetin social "Instagram", ka thënë se do t'i falë ata që i kërkojnë falje.

"Unë nuk dua të përfundoj këtë vit me raporte të këqija me dikë. Më kërkonin falje. Do t'ju fal të gjithëve", ka shkruar reperja.



Pas divorcit me Brad Pittin, Angelina Jolie pati disa takime

Angelina po futet sërish në lojën e romancave. Sipas një burimi për "Us Weekly", aktorja raportohet se 'ka qenë në

disa takime'. Ndërsa Angie ka qenë duke shijuar statusin e saj të vetëm, 'asgjë serioze' nuk ka ardhur nga këto takime ende.

Celine publikon album të ri



Celine Dion e ka publikuar albumin më të ri muzikor me titull "Courage". Ky është albumi i parë i saj në gjuhën angleze në gjashtë vjetët e fundit dhe përmban këngë tashmë të publikuara si "Imperfections", "Lying Down" dhe

këngën kryesuese "Courage". Justjared ka shkruar në rrjetet sociale se nëse doni ta dëgjoni Celine duke performuar disa prej këtyre këngëve të reja live në koncert, jeni me fat sepse Turneu Botëror Courage veçse është duke ndodhur.



Selimi: Kualifikueset ishin pozitive për Kosovën, në Evropian nga Liga e Kombeve

Përfaqësuesja e Kosovës në futboll nuk arriti ta sigurojë kualifikimin në Kampionatin Evropian nëpërmjet kualifikimeve, por trajneri Musa Selimi ka shprehur optimizëm se "dardanët" mund të kualifikohen në "Euro 2020" nga Liga e Kombeve. "Humbja ndaj çekëve duhet të harrohet sa më parë dhe të fillojmë të mendojmë për të ardhmen, të punojmë edhe më shumë në mënyrë profesionale dhe të shkojmë sa më të përgatitur në ndeshjen e Ligës së Kombeve. Kemi shanse të mëdha që të kualifikohemi në Evropian. Do të ishte një sukses historik për sportin dhe shtetin tonë", ka deklaruar Selimi



edhe punën e përzgjedhësit Bernard Challandes. "Trajneri Bernard Challandes ka bërë një punë të jashtëzakonshme dhe duhet që me bashkëpunëtorët të vazhdojë të ngritë edhe më lart lojën e Kosovës, e cila çdo ditë e më shumë po dëshmon potencialin", ka përfunduar Selimi.

Finalja e Ligës së Kombeve mund të luhet në 'Fadil Vokrri'

Përfaqësuesja e Kosovës ka mundësi të madhe që finalen e Ligës së Kombeve ta zhvillojë në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Kosova të enjten, pas humbjes ndaj Çekisë, edhe zyrtarisht humbi shpresat për një kualifikim të mundshëm përmes grupeve eliminatorë. Mirëpo Kosova ka edhe një rast tjetër që përmes Ligës së Kombeve ta kërkojë kualifikimin në "Euro 2020". "Dardanët" takohen me Maqedoninë në Shkup dhe në rast se arrijnë fitore në finale, do të përballen me fituesin e duelit Gjeorgji - Bjellorusi.

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Trajneri dhe analisti i futbollit në Kosovë, Musa Selimi, të premten për "Epokën e re" ka thënë se duhet që të gjithë futbollistët të pajtohen me humbjen e "dardanëve" në ndeshjen kualifikuese kundër Çekisë (2-1). Sipas tij, çekët e kanë merituar më shumë fitoren në këtë ndeshje sepse kanë luajtur më mirë se Kosova. "Ka qenë një dëshirë e madhe e Kosovës që të arrijë fitore në ndeshjen ndaj Çekisë, por dëshi-

ra nuk mjafton gjithmonë që të arrihet synimi. Duke u bazuar në lojën e zhvilluar nga të dyja palët, mund të them se çekët me meritë kanë shënuar fitore. Ne duhet të pajtohemi me këtë humbje dhe të vazhdojmë t'i mbështesim yjet tanë në secilën lojë në të ardhmen. Pavarësisht prej humbjes në ndeshjen e fundit, futbollistët na bënë krenarë me atë që kanë treguar në vitet e fundit, por edhe me të arriturat", ka thënë Selimi. "Nëse u bëjmë analizë të gjitha ndeshjeve të Kosovës në ndeshjet kualifikuese mund t'i vlerësojmë si të

suksesshme. Kjo ishte hera e parë që ne ishim pjesë e kësaj faze dhe kemi arritur rezultate mbresëlënëse, por edhe paraqitje superiore. Kemi lënë përshtypje të mira dhe kemi marrë vëmendjen e mediave botërore", ka shtuar Selimi. Ish-trajneri i shumë klubeve në Kosovë, përfshirë Gjilanin, Dritën e Feronikelin, Musa Selimi, ka shprehur optimizëm se Kosova mund ta arrijë kualifikimin nëpërmjet ndeshjeve në Ligën e Kombeve. "Dardanët" në muajin mars do të përballen në gjysmëfinale kundër

Maqedonisë në Shkup dhe nëse arrijnë fitore në finale do të luajnë kundër fituesit të ndeshjes Gjeorgji-Bjellorusi. "Humbja ndaj çekëve duhet të harrohet sa më parë dhe të fillojmë të mendojmë për të ardhmen, të punojmë edhe më shumë në mënyrë profesionale dhe të shkojmë sa më të përgatitur në ndeshjen e Ligës së Kombeve. Kemi shanse të mëdha që të kualifikohemi në Evropian që do të ishte një sukses historik për sportin dhe shtetin tonë", ka deklaruar Selimi. Në fund, Selimi ka vlerësuar lart

12 milionë euro për renovimin e stadiumit 'Adem Jashari'



MITROVICË, 15 NËNTOR - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, sot ka pritur në një takim drejtorin e Departamentit të Sportit në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Iber Alaj, me të cilin kanë biseduar rreth projektit për renovimin e stadiumit "Adem Jashari" në Mitrovicë. Në këtë takim ishin të pranishëm nënkryetari i komunës, Faruk Mujka, drejtori për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Hysen Muzliukaj, drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport, Tafil Peci, zyrtarë nga drejtorja e Urbanizimit dhe Shërbimeve

Publike, përfaqësues nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit si dhe hartues të këtij projekti. Gjatë këtij takimi përfaqësuesit nga MKRS-ja dhe hartuesit e projektit kanë prezantuar projektin madhor për renovimin e stadiumit "Adem Jashari", i cili do të kushtojë mbi 12 milionë euro. Projekti parasheh renovimin e tërësishëm të stadiumit, të ketë parking publik, parkingun për VIP, parkingun për media, park rekreativ, fushat e tjera ndihmëse si dhe hapësirën për tifozët mysafirë. Sipas drejtorit të Departamentit

të Sportit, Iber Alaj, stadiumi "Adem Jashari" nga kategoria 2 do të kalojë në kategorinë e 4 sipas rregullores UEFA dhe FIDIC, duke i mundësuar kështu Përfaqësueses së Kosovës në futboll të zhvillojë ndeshje zyrtare dhe ndërkombëtare. Me këtë rast kryetari i komunës, Agim Bahtiri, ofroi mbështetjen e tij të plotë për realizimin e këtij projekti, duke kryer të gjitha procedurat komunale si dhe lirimim e pronave komunale, në mënyrë që të fillojnë punimet sa më shpejt dhe të krijohen kushte sa më moderne për sportistët tanë.


Vazhdon të mbetet jashtë funksionit faqja për shitjen e biletave për ndeshjen Kosovë - Angli

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll të dielën e zhvillon ndeshjen e fundit eliminatorë ndaj Kombëtares së Anglisë në stadiumin "Fadil Vokrri". Problemi me shitjen e biletave vazhdon të jetë i pandryshuar

për faktin se që nga dalja në shitje e këtyre biletave, qytetarët kanë hasur në probleme të njëpasnjëshme për t'i blerë ato. Sistemi online i shitjes së biletave për këtë ndeshje, "tiks.app", ka dështuar që nga fillimi. "KosovaPress" ka

pyetur personat përgjegjës të këtij sistemi se kur do të fillojë shitja e biletave të mbetura për këtë ndeshje, mirëpo ende nuk ka marrë asnjë përgjigje. Teksa mijëra tifozë presin ta kuptojnë kohën kur do të tentojnë ta blejnë një biletë,

"tiks.app" ka njoftuar se tashmë një pjesë e tyre janë shitur. Kujtojmë që në njoftimet e mëparshme të kësaj kompanie, "tiks.app" ka shkruar se deri më tani janë shitur rreth 10 000 bileta dhe në shitje janë edhe 2 000 të tjera.



Sot takohen Feronikeli - Kosova Zurich

DRENAS, 15 NËNTOR - Organizuar nga Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, në bashkëpunim me Unionin e Klubeve Shqiptare të Futbollit në Zvicër dhe Federatën e Futbollit të Kosovës, do të mbahet finalja e Superkupës

mbarëkombëtare. Ndeshja për Superkupë zhvillohet ndërmjet ekipit të futbollit FC Feronikeli nga Drenasi dhe FC Kosova Zurich nga Zvicra. FC Feronikeli është fitues i Kupës së Kosovës për vitin 2019, ndërsa FC Kosova Zurich është

fitues i Kupës së Diasporës për vitin 2019. Dy skuadrat do të ballafaqohen në superfinale, kurse kjo ndeshje zhvillohet më 16 nëntor (e shtunë) në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas, duke filluar nga ora 13:00.



U prezantua kimonoja që do ta përfaqësojë Kosovën në LO 'Tokio 2020'



PRISHTINË, 15 NËNTOR - Në Bibliotekën Kombëtare "Pjetër Bogdani" në Prishtinë është prezantuar kimonoja që do ta përfaqësojë Kosovën në ceremoninë hapëse të Lojërave Olimpikë "Tokio 2020". Kimonoja është dizajnuar nga japonezja Naoe Kawamura, ndërsa kimonoja përmban ngjyrat e flamurit të Kosovës. Gjatë fjalës së tij, kryetari i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, ka thënë se ngjyrat e kimonos janë shumë të

dashura sepse me ato Majlinda Kelmendi e fitoi medaljen e artë në Lojërat Olimpikë "Rio 2016". "Normalisht këtu ka mjaft sportistë nga Kosova, sportistë të cilët do të jenë në Lojërat Olimpikë "Tokio 2020" dhe para tyre do të jetë kjo kimono aq e bukur me këto dy ngjyra që i bën shumë të dashura për ne, ngjyra ato me të cilat edhe Majlinda Kelmendi në Lojërat e para Olimpikë "Rio 2016" u stolis me medaljen e artë olimpikë dhe e vendosi Kosovën në mesin e 100

shteteve që kanë medalje të artë olimpikë", ka thënë Hasani. Ndërsa Naoe Kawamura që dizajnoi kimonon ka thënë se është e veçantë për faktin se përmban motive nga Kosova, duke u nisur nga historia, veshjet tradicionale, peizazhet etj. Dizajnin e kimonos e vlerësoi lart edhe zëvendësministria Leonora Morina-Bunjaku. Lojërat Olimpikë "Tokio 2020" mbahen në kryeqytetin e Japonisë prej 24 korrikut deri më 9 gusht të vitit të ardhshëm.

Tjetër dështim nga clippersat, fitojnë Milami dhe Chicago

NEW ORLEANS, 15 NËNTOR - New Orleansi u ka dhënë një leksion clippersave në ndeshjen e radhës në NBA, duke fituar me rezultat 132-127. Një ndeshje spektakolare mes dy skuadrave, ku herë kryesonte njëri ekip e herë tjetri. Gjithsesi, në fund triumfoi skuadra e Pelicansit, ku u dallua Holiday me 36 pikë, mbështetur edhe nga Favorsi me 20 pikë e 20 rebounde. Fitore ka arritur edhe skuadra e Denverit, që ruan pozitën në vendin e dytë në Perëndim, pas triumfit 101-93 ndaj Brooklynit. Më të mirët në fushë ishin Jokiq e Harris, me



nga 18 pikë secili. Tjetër ndeshje e mirë për MVP-në e sezonit të fundit, Giannis Antetokounmpo që, falë 38 pikëve e 16 reboundeve, i dha fitoren ekipit të Milwaukee. Skuadra e Bucksit triumfoi 124-115 ndaj Chicagos, ku për vendësit u dallua edhe Bledsoe me 31 pikë. Ekipi i

Phoenixit e mposhti me rezultat 128-112 Atlantan, ndeshje e dominuar nga Sunsi, me dyshen Oubre-Booker, që së bashku realizuan 57 pikë. Jashtë fushës fitoi edhe skuadra e Miamit, e cila e mundi 108-97 Clevelandin, ndeshje ku u dallua Nunn me 23 pikë.

REZULTATET

Cleveland - Miami	97-108
Milwaukee - Chicago	124-115
New Orleans - Clippers	132-127
New York - Dallas	106-103
Phoenix - Atlanta	128-112
Denver - Brooklyn	101-93

SHKURT

Ibra planifikon të pensionohet në Itali

Sulmuesi Zlatan Ibrahimović po planifikon të pensionohet në Itali. Këtë lajm e ka konfirmuar trajneri i Los Angeles Galaxy, Guillermo Barros Schelotto. 39-vjeçari të mërkurën bëri me dije se nuk do ta vazhdojë kontratën me klubin nga liga MLS, kurse ai pritet t'i bashkohet njërit prej klubeve nga Seria A. Interesim për sulmuesin suedez ka shfaqur Milani, Napoli dhe Bologna.

Sanchezi nuk bën pjesë në planet e Unitedit

Klubi anglez i Manchester Unitedit ka vendosur për të ardhmen e sulmuesit Alexis Sanchez. Unitedi nuk e ka ndërmend ta rikthejë sërish në "Old Trafford" sulmuesin kilian, i cili është i huazuar në Inter, pasi objektivi i "Djajve të kuq" është transferimi i sulmuesit të Salzburgut, Erling Braut Haaland.

Juve synon transferimin e Donnarummas

Skuadra kampione e Italisë, Juventus, po synon që të transferojë portierin e AC Milan, Gianluigi Donnarumma. "Gazzetta dello Sport" raporton se "Zonja e Vjetër" është e gatshme t'i ofrojë Milanit një nga mbrojtësit Rugani ose Demiral dhe një shumë të konsiderueshme të të hollave. 20-vjeçari është pjesë e Milanit nga viti 2015 dhe që nga atëherë ka realizuar 153 paraqitje.

Lippi sërish largohet nga Kina

Trajneri italian Marcello Lippi është larguar nga posti i trajnerit të Kinës. Dorëheqja e Lippit ka ardhur pas humbjes nga Siria (2-1) në ndeshjen kualifikuese për Kampionatin Botëror të vitit 2022. "Nëse e prezantoj një ekip të këtyllë në fushë... fitoj shumë para. Dhe nuk dua që t'ua vjedh (ato para). Prandaj, po jap dorëheqje të parevokueshme", ka deklaruar 71-vjeçari. Lippi e kishte drejtuar Kinën nga viti 2016 deri në vitin 2019, më pas ishte larguar për t'u rikthyer sërish në muajin mars. Gjatë karrierës ai ka drejtuar edhe Italinë dhe skuadrat e njohura si Milan, Juventus, Inter dhe Napoli.

Torino planifikon t'i shesë Zazan dhe Falquen

Torino pritet të bëjë ndryshime në afatin kalimtar të janarit. Mazzarri pret përforsime për ta nisur ringritjen dhe fillimisht drejtuesit duhet t'i shesin ata që nuk bëjnë pjesë në planet e trajnerit. Simone Zaza dhe Iago Falque do të jenë në shitje në janar me synimin për t'u shitur dhe me buxhetin e krijuar të afrohen 2-3 lojtarë të tjerë. Për Iago Falque nuk mungojnë ofertat si nga Italia, Spanja apo edhe Kina, ndërsa sulmuesi Zaza pritet të largohet në formë huazimi me të drejtë blerjeje te Sampdoria ose Brescia.

Mick Schumacher piloton makinën e suksesshme të babait

Dita e premte ka qenë e veçantë për 20-vjeçarin gjerman Mick Schumacher, që në pistën e Fiorano (Itali) ka pilotuar makinën Ferrari F2002, me të cilën babai i tij ka fituar titullin kampion (2002). Me atë makinë, 7 herë kampioni i botës në Formula 1, fitoi 10 nga 17 garat sezonale, duke fituar titullin atë sezon që në korrik. "Jam me fat që kam mundësinë të pilotoj këtë makinë magjike. Është një ëndërr që bëhet realitet për mua, ta pilotoj makinën kampione të babait tim. Kjo është hera e parë që unë provoj një makinë në pistën e Fioranos, ndaj ndihem i privilegjuar", u shpreh Mick Schumacher, që këtë sezon garon në botërorin e Formula 2.



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.
VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.

Sheshi "Bil Klinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bil Klinton" Br.13 Prishtina, Kosovo
Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: info@iber-lepenc.org

Ndërmarrja Hidroekonomike „Ibër-Lepenc” S.H.A. – Prishtinë, publikon këtë:

KONKURS

1. Zyrtar për politika të çmimeve, kontraktive, licenca, shërbime si dhe leje ujore (1)

Detyrat dhe përgjegjësitë së këtij zyrtari do të jenë si vijim:

- Në emër të Ndërmarrjes është i autorizuar për bashkëpunim dhe kontakte me; Autoritetin Rregullator për shërbimet e ujit (ARRU), Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) dhe Ministrinë përkatëse për leje ujore;
- Përgatitë dokumentacionin e nevojshëm për aplikim;
- Aplikon në emër të Ndërmarrjes për licenca dhe leje ujore;
- Kujdeset për validitetin e licencave dhe lejeve ujore;
- Kujdeset për përtrirjen e licencave të shërbimeve nga autoritetet rregullative përkatëse;
- Vazhdimin e lejes ujore nga Ministria përkatëse;
- Bashkëpunon me zyret dhe departamentet përkatëse të Ndërmarrjes që kanë të bëjnë me politikën e çmimeve për shërbimet e ofruara nga Ndërmarrja;
- Mbikëqyrë faturimin e tarifave të licencave dhe lejes ujore;
- Lejon pagesat për licenca dhe leje ujore;
- Propozon kontrata për shfrytëzuesit e shërbimeve të Ndërmarrjes;
- Kryen edhe punët dhe detyra tjera të ngjashme që kanë të bëjnë me politikën e çmimeve dhe ofrimin e shërbimeve të Ndërmarrjes ;
- Për punën e vet i i përgjigjet KE të Ndërmarrjes.

Kushtet:

- Fakulteti ekonomik;
- Përvoja e punës së paku 3 (tri) vite ;
- Njohuri e programeve kompjuterike;
- Njohja e gjuhës angleze do të jetë përparësi;

Marrëdhënia e punës: Në kohë të caktuar deri në një vit, me punë provuese deri në 6 muaj, me mundësi të vazhdimit .

2. Zyrtar ligjor (1)

Detyrat dhe përgjegjësitë do të jenë si vijim:

- Kryen të gjitha punët juridiko-administrative që kanë të bëjnë me ruajtjen e pronës, vlerësimin e dëmeve të shkaktuara të palëve, përgatitjen e ofertave dhe marveshjeve të kompenzimit dëmi etj;
- Bashkëpunon me Drejtoratet Komunale për qështje juridiko pronësore;
- Bashkëpunon me Drejtoratet Komunale për qështje të inspektionit, me qëllim të ruajtjes përkatësisht lirimit të pronës së ndërmarrjes.
- Përfaqëson në gjykata etj.
- Kryen edhe punët tjera të kërkuara nga eprori, të cilat i përgjigjen përgatitjes profesionale dhe aftësive të fituara me punë, të cilat kanë të bëjnë me natyrën e punëve të këtij vendi të punës;
- Për punën e vet i raporton dhe i përgjigjet shefit të shërbimit dhe Drejtorit.

Kushtet:

- Fakulteti Juridik;
